

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Njesia Orig. 0113 Nr. Prof. 1896
 Org. Jedin. Br. Prof.
 Org. Unit Prof. No.
 Nr. i faqevave 66 Data: 05-06-23
 Broj stranica Datum:
 No. pages Date:

PRISHTINE A NO.1



Kompania Rajonale e Ujësjesit
 "Hidroregjioni Jugor" SH.A.
 "Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren
 Tel/Fax: 029/244-150 029/244-107
 E-mail: sha-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

HIDROREGJIONI JUGOR SH.A.D.D
 1763
 29.05.2023
 PRIZREN

Bordi i Drejtorëve në K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2023 mori këtë:

VENDIM
RAPORTI – TM1-2023

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi raportin e TM1 për vitin 2023 në mbledhjen e 19 (nëntëmbëdhjetë) të mbajtur me datë 29.05.2023.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Zenel Zemelaj	Kryesuesi e BtD Feim Fetoshi
Nënshkrimi		
Data	29.05.2023	29.05.2023





KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.a., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



RAPORT - TM1 2023

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. - PRIZREN

PËRMBAJTJA

I.	ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE	3
II.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	4
III.	DEPARTAMENTI TEKNIK	6
3.1	PRODHIMI m ³ – TM1-2023	6
3.2	SITUATA E FURNIZIMIT.....	7
3.3	AKTIVITETET KRYESORE.....	7
3.3.1	AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE	9
3.3.2	MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE	9
3.3.3	SHËRBIMI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM	10
3.3.4	SERVISIMI I UJËMATËSAVE.....	11
3.3.4	DETEKTIMI I RRJETIT	12
3.3.5	CILËSIA E UJIT	12
3.4	PROBLEMET E EVIDENTUARA	15
3.5	MASAT E REALIZUARA.....	15
3.6	MASAT E PROPOZUARA	15
IV.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	16
4.1	PERFORMANCAT – TM1-2023	16
4.1.1	NUMRI I KONSUMATORËVE.....	16
4.1.2	FATURIMI – m ³	17
4.1.3	FATURIMI – €.....	18
4.1.4	ARKËTIMI – €	19
4.2	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	20
4.2.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	20
4.2.2	ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE.....	20
4.2.3	INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA.....	21
4.2.4	PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE.....	22
4.2.5	MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE.....	22
4.2.6	MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NË VAZHDIM.....	22
V.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	23
5.1	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE	23

5.1.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	23
5.1.2	ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE.....	24
5.1.3	PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE.....	25
5.1.4	MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE.....	26
5.1.5	MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHË NË VAZHDIM.....	26
5.2	TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS.....	26
VI.	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	27
6.1	NJËSIA OPERATIVE- PRIZREN.....	27
6.2	NJËSIA OPERATIVE- SUHAREKË.....	28
6.3	NJËSIA OPERATIVE- DRAGASH.....	29
6.4	NJËSIA OPERATIVE- MALISHEVË.....	30
6.5	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN.....	31
6.6	REALIZIMI I CAQEVE- TM1-2023.....	32
6.7	TRANSAKSIONET KRYESORE- TM1-2023.....	33
VII.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	34
7.1	KOMENTET KRYESORE.....	34
7.1	PERSONELI.....	35
7.2	ZYRA LIGJORE.....	38
VII.	DEPARTAMENTI I UN -ITUN.....	43
7.1	KOMENTET KRYESORE.....	43
7.1.1	FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN.....	43
VIII.	AUDITIMI I BRENDSHËM.....	55
IX.	AKTIVITETET E PROKURIMIT – TM1-2023.....	57
X.	INVESTIMET KAPITALE.....	59
XI.	ZBATMI I STRATEGJISË PËR ZVOGLIMIN E UPF-së.....	60
XII.	RAPORTIM FINANCIAR PËR MINISTRIN E FINANCAVE.....	62
XIII.	ORGANOGRAMI.....	64

I. ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësllësit, viti 2023



LEGJENDA:

05	Zona e shërbimit
06	Qytetet me ujë
07	Ferizadit me ujë që transportohet nga HES
1.19	Interkomuna të shërbimit të ujësllësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

II. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

JANAR 2023

- Vizitë nga M Ekonomisë -Artane Rizvanolli -16/01/2023
Tema : Performanca e Kompanisë përgjatë vitit 2022 dhe sfidat
- Takim në Prishtinë – Shukos me shoqatën si motër VSA _Zvicerane -16/01/2023
Tema : Avancimi dhe rritja e Shukosit
- Mbledhja e Bordin e Drejtoreve - 1/01/2023
- Mbledhja me menaxhmentin e Kompanisë
Tema : Përgatitja e Planeve mujore , tre mujore , plani i veprimit dhe caqet e parapara sipas biznes Planit .
- Vizitë në Mitrovicë -20/01/2023
Tema : Ndhma pas vërshimeve
- Mbledhja e Menaxhmentit
Tema : Analiza e Performances Mujor dhjetor2022 -22/01/2023
- Takim në Prishtinë M. Ekonomisë(Njësinë për monitorimin NP.) -25/01/2023
Tema : Problemi i Zyrave të Kompanisë
- Mbledhja e Bordit të drejtoreve
Tema : Performanca e kompanisë Dhjetor 2022
- Takim me M. Infrastrukturës (Njësia ne Prizren) -31/012023
Takim : Harmonizimi i investimeve përgjatë riparimit te infrastrukturës rrugore

SHKURT 2023

- Takim me menaxhmentin e Kompanisë -01/02/2023
Tema : organizimi, planifikimi dhe implementimi
- Takim ne Gjakovë KRU “ Gjakova “ -02/02/2023
Tema : Mbledhja e Shukos
- Takim ne M. Ekonomisë 06/02/20223
Tema : Sistematizimi; Nivelizimi; organogrami
- Takim me ARRU-në -07/02/2023
Tema: Verifikimi I të dhënave
- Takim ne ITUN -07/02/2023
Tema : Analizimi I punimeve të përfunduara –Performanca
- Takim ne Prishtinë -14/02/2023
Tema : Harmonizimi I investimeve -Performanca

- Mbledhja e Bordit te Drejtoreve 16/02/2023
Tema : sipas rendit
- Takim ne Prishtinë – M,E ,(Njësia Monitoruese)22/02/2023
Tema :Diskutim - Plani I Menaxhimit te Llunit
- Takim ne Prishtinë –Zv. Kryeministren 23/02/2023
Tema : Investimet ne fshatin Grenqarë
- Mbledhja e B,D, - 24/02/2023
Tema : Shqyrtimi I Organogrami, Sistematizimi, Nivelizimi

MARS 2023


- Takim Ne Suharekë- 01/03/2023
Tema : Investimet kapitale
- Takim Menaxhmentit -02/03/2023
Tema : Performanca e Kompanisë
- Takim me Prizren – Koordinatori për punësim -07/03/2023
Tema : Memorandumi i punësimit
- Takim ne Malishevë - 08/03/2023
Tema : Marrëveshje e Investimeve
- Takim Deputetin - 10/03/2023
Tema : investimet në Prizren
- Takim në Komunën e Suharekës (Kryetarin) – 13/03/2023
Tema : Harmonizimi I investimeve
- Takim ne Malishevë (Kryetarin) 15/03/2023
Tema : Studimi I fizibilitetit të furnizimit me ujë për Malishevën
- Takim në Prishtinë -16/03/2023
Tema : Kuvendi i Shukosit
- Mbledhja e Bordit të Drejtoreve – 20/03/2023
- Takim i Menaxhmentit 21/03/2023
Tema : Analiza e Projektit me Konsumator
- Takim ne Prishtinë (MA dhe P. Hapësinor) 22/03/2023
Tema : Prezantimi i planit te vërshimeve
- Takim me ARRU-në -23/03/2023
Tema : përformance e Kompanisë
- Mbledhja e Menaxhmentit – 29/03/2023
Tema : Performanca e Kompanisë
- Mbledhja e Bordit te drejtoreve -31/03/2023

III. DEPARTAMENTI TEKNIK

3.1 PRODHIMI m3 – TM1-2023

Tabela Nr.1 - Prodhimi – TM1 2023

TM1 - 2023				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN				
P R O D H I M I - m3				
NJËSIA PUNUESE	TM4-2022		TM1-2023	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	166.8	2,622,600	162.8	2,573,700
SUHAREKË	41.3	649,421	40.0	632,050
MALISHEVË	23.1	363,633	22.9	362,407
DRAGASH	14.9	234,813	15.7	247,800
TOTAL	246.1	3,870,467	241.3	3,815,957
NDRYSHIMI l/sec				(54,510)
NDRYSHIMI %				-1.41%



3.2 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për periudhën tremujore, Janar – Mars 2023, në nivel regional duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i plotë dhe i rregullt me përjashtime shumë të vogla dhe të pjesëshme të furnizimit në disa lokalitete nga ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike dhe problemeve të natyrshme që shfaqen në rrjetë dhe puset furnizuese.

Gjatë kësaj periudhe tremujore kemi realizuar furnizimin stabil, kualitativ dhe kuantitativ duke përmbushur standardet aplikative për furnizim 24h dhe cilësi 100 % të ujit të pijes dhe duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Furnizimi stabil dhe i kënaqshëm vije si rezultat i kushteve të volitshme atmosferike dhe investimeve të vazhdueshme në përmirësimin e rrjetit në përgjithësi me theks të veçantë në zonat problematike të furnizimit.

3.3 AKTIVITETET KRYESORE

Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve komfor detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit Teknik në veçanti dhe Kompanisë në përgjithësi.

Takimet e rregullta ditore, javore dhe mujore të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me udhëheqësit e njësive punuese dhe shërbimet tjera të Kompanisë.

Raportet e rregullta për menaxhment, KE, BD, ARRU dhe Institucionet tjera monitoruese dhe ndërvepruese me Kompaninë.

Takimet me institucionet komunale, qeveritare, me institucione financiare donatore, me konsumatorë etj.

Takimet, raportet, përgjigjet dhe shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike me ARRU, IM, KNMU, sektorët e ujit dhe energjisë dhe Institucionet e agjencionet e ndërlidhura drejtpërdrejte apo indirekt me monitorimin e Kompanisë dhe të tjera të ngjashme në funksion të përgjegjësi dhe përmbushjes së detyrimeve karshi standardeve operuese aplikative.

Aplikimi dhe procedimi i kërkesave, ankesave dhe shkresave zyrtare që lëshon DT - Përgjigjeve në kërkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pëlqimeve komfor Rregulloreve të zbatueshme të Kompanisë.

Përpunimi final i Rregullores për sistematizim, nivelizim dhe përshkrim të detyrave të punës për stafin e kompanisë në përgjithësi dhe stafin e DUP-së në veçanti.

Menaxhimi i projekteve të investimeve kapitale sipas planifikimeve të PB 2023 dhe projekteve e aktiviteteve tjera investive e operative komfor kërkesave dhe nevojave të shfaqura nga shërbimet e kompanisë, konsumatorët dhe institucionet tjera si objektiv konsistent në avancimin e funksionimit dhe efikasitetit të Kompanisë me theks të veçantë:

PIF Projekt propozimet për investime kapitale për Qeveri – 5 projekte

KASH – projekt propozime kapitale për ME.

Projektet investive nga komunat e qeveria–mbikëqyrja, asistimi dhe participimi.

Kompletimi i dokumentacioneve tekniko-investive dhe procedimi për prokurim të projekteve sipas PB 2023 dhe projekteve tjera për furnizime e shërbime.

Harmonizimi i projekteve investive dhe përpilimi e finalizimi i projekt propozimeve teknike të përgatitura nga DT me të gjitha Institucionet financiare vendore (Qeveria), komunale (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash), e fonde tjera përmes përpilimit, monitorimit dhe kontributit në realizimin e Marrëveshjeve të bashkë investimit apo praktikave të ngjashme.

Gjatë periudhës tremujore janë finalizuar:

Marrëveshja nr. 400/16.02.2023, me emërtimin: "Projekti studimor dhe investiv për furnizim me ujë të pijes për komunën e Malishevës" – 70,000.00 €.

Marrëveshja nr. 822/30.03.2023, me emërtimin: "Ndërtimi i infrastrukturës së re të rrjetit të ujësjellësit në rrugën 'Ibrahim Mazreku' – Malishevë".

Marrëveshja nr. 401/16.02.2023, me emërtimin: "Investimi në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, shtimin e kapaciteteve ujore dhe zgjerimin e sistemit të ujësjellësit në disa zona dhe lokalitete të komunës së Malishevës" – 63,120.00 €.

Marrëveshja nr. 677/14.03.2023, me emërtimin: "Vazhdimi i gyp sjellësit ekzistues PE ø 250 mm në transitin e ri të qytetit të Prizrenit, L ≈ 180 m.

Shqyrtimet dhe analizat profesionale të stacioneve dhe sistemeve elektro pompuese, përpilimi i projekt dokumentacioneve investive për elektro pompa, kontributi në finalizimin e projekt dokumentacioneve investive për furnizim me material elektrik, pështjellimin dhe servisimin e elektromotorëve, furnizimin me automjete, vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës dhe furnizime tjera të ngjashme.

Kontributi profesional në zbatimin dhe avancimin e aplikacioneve softverike dhe menaxheriale në shërbim të rritjes së efikasitetit të Kompanisë (MMS&MMA, EDAMS, monitorimi i objekteve, etj.) .

Mbështetja dhe kontributi në vazhdimësi rreth planifikimeve dhe hartimeve të dokumentacioneve strategjike, sigurisë së burimeve ujore, menaxhimit të krizave, menaxhimit të aseteve, auditimet dhe evaluimet teknike me bashkëpunëtorët e DT te

raporteve për institucionet kompetente dhe projekteve të papërfunduara dhe ato në ekzekutim e sipër.

Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak në mungesë të zëvendësimit në cilësinë e menaxherit të projekteve. Menaxhimi i kontratave të filluara nga pozicioni paraprak dhe në vijimësi me OE vendor dhe ndërkombëtar, me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procedimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike të telekomunikuese, përkrahjen dhe ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e projekt dokumentacione investive propozimi i para masave dhe para llogarive në fushën elektroteknike, kujdesi për mbarëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

3.3.1 AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

- Riorganizimi dhe ristrukturimi i shërbimeve brenda DUP-së komfor procesit në vazhdim të sistematizimit dhe organogramit të ri të Kompanisë me objektiv të veçantë në divizionin për UPF.
- Përpilimi i planeve operative ditore dhe periodike me të gjitha shërbimet përkatëse dhe intervenimet në sanimin e prishjeve në rrjetë, rrjedhjeve të pakontrolluara, shkyçjen e lidhjeve ilegale, etj.
- Instalimi dhe finalizimi i vendosjes së ujëmatësve të prodhimit në të gjitha pikat furnizuese në nivel të kompanisë.
- Detektimi i rrjetit të ujësjellësit, ndërrimi i ujëmatësve dhe ndarja e zonave për detektim për zvogëlimin dhe eliminimin optimal të humbjeve teknike.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit dhe segmenteve tjera në zonën e mbulueshmërisë me prishje të shpeshta dhe jo funksionalitet të duhur sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemet monitoruese aplikative, shërbimit operativ dhe matjeve në teren. përmes investimeve të vazhdueshme vetanake dhe bashkë investimeve me komunat, qeverinë dhe institucionet tjera financiare.

3.3.2 MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE

Tabela Nr.2 – Sanimi i defekteve – TM4 2022

Njësia Operative	Ujësjiellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Total	751	191	942

Tabela Nr.3 – Sanimi i defekteve – TM1 2023

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	449	87	536
Suharekë	93	28	121
Dragash	13	06	19
Malishevë	88	10	98
Total	643	131	774

3.3.3 SHËRBIMI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

- Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
- Përgatitja e raportit të performancës për ARRU dhe auditim nga ARRU.
- Përpilimi i raportit vjetor për ARRU – raporti vjetor i performancës 2022.
- Auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).
- Raporti mjedisor dhe social – BERZH.
- Përgatitja e listës së projekt propozimeve për KASH.
- Përgatitja e projekteve për PIF.
- Regjistrimi i mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët - KRU “HRJ
- Regjistrimi i materialit në depo kryesore dhe servisit e bazdarimit – KRU “HRJ”
- Përpilimi i termave të referencës për burimet e ujit në Malishevë dhe projekti për rehabilitimin e rrugëve në qytetin e Malishevës dhe fshatin Banjë.
- Përgatitja e projektit për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Bllacë – Suharekë.
- Takim pune me DSHP, INSI dhe HRJ në zyrat e DSHP – Prizren, tema raporti fillestar për studimin e fisibilitetit për burimet në jug-perëndim të qytetit të Prizrenit.
- Përcjellja e komenteve nga komiteti i KRU “HRJ” të kompania INSI për raportin fillestar të studimit të fisibilitetit për burimet në jug-perëndim të qytetit të Prizrenit.
- Takim pune në zyrat e kompanisë me kompaninë e INSI për raportin e parafisibilitetit për burimet në jug-perëndim të qytetit të Prizrenit.
- Vizitë pune në Maqedoni për tuba të kanalizimit
- Vendosja e ujëmatësve të prodhimit – aktivitet regjional në kuadër të kompanisë.
- Përpilimi i projekt propozimeve: Rr. “Xhemë Gostivari”, Rr. “Junus Emra”, Rr. “Gucia”
- Mbikëqyrje të projekteve në kuadër të KRU “HRJ”: 5 rrugët në Prizren, Landovicë, Lagja e Bajraktarëve, Peqan dhe rruga Xhavit Sylja.
- Inicimi i projekteve për realizim.

- Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
- Vlerësimi i kontratave në Prokurimit.
- Mbikëqyrje të projekteve në kuadër të KRU “HRJ”.
- Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
- Pasurimi i GIS-it me të dhëna.
- Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në tabelë.

3.3.4 SERVISIMI I UJËMATËSAVE

Tabela Nr.4– Servisimi i ujëmatësve – TM4 2022

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Tetor-Dhjetor - 2022	
Kalibrim i ujëmatësve (Bazhdarim)	285	riparime të ujëmatësve
	6	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	461	vizita të konsumatorët
	250	ndërrime të ujëmatësve
	81	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Bllombimit	572	bllombim dhe kontrata
	1270	dera mbyllur të konsumatorët
	52	kërkesa nga konsumatorët për bllombim
	1	konsumator duhet të ndërrohet ujëmatësi
	2	konsumatorëve duhet zëvendësuar ujëmatësi
	1	konsumator që duhet të ndërrohet regjistrohet

Tabela Nr.5– Servisimi i ujëmatësve – TM1 2023

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Janar-Mars - 2023	
Kalibrim i ujëmatësve (Bazhdarim)	299	riparime të ujëmatësve
	12	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	474	vizita të konsumatorët
	265	ndërrime të ujëmatësve

	70	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	157	detekttime
	97	defekte të gjetura
	3,910	rrjet i detektuar (m)
Bllombimit	484	bllombim dhe kontrata
	1267	dera mbyllur të konsumatorët
	57	kërkesa nga konsumatorët për bllombim

3.3.4 DETEKTIMI I RRJETIT

Tabela Nr.6– Detektimi – TM4 2022

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Tetor-Dhjetor - 2022	
Detektimit të rrjetit	204	detekttime
	146	defekte të gjetura
	5,030	rrjet i detektuar (m)

Tabela Nr.7– detektimi – TM1 2023

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Janar-Mars - 2023	
Detektimit të rrjetit	157	detekttime
	97	defekte të gjetura
	3,910	rrjet i detektuar (m)

3.3.5 CILËSIA E UJIT

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.

Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit.

Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe sasinë e cila shfrytëzohet.

Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarëvajtjen e procesit dhe pajisjeve.

Përcjellja permanente e turbiditetit në burime për shkak të reshjeve të mëdha dhe ndotjes së burimeve, largimi dhe futja e burimeve në sistem dhe koordinimi i sasisë së klorit varësisht nga sasia e ujit në rrjet.

Rregullimi i sasisë së nevojshme të klorit në rrjet në kohën deri sa u sanua defekti nga “40-Burimet”.

Mostra që nuk përgjigjet është në Studenqan, shkak mungesa e klorit residual-SHENJAT (defekt teknik). E kemi sanuar problemin.

Tabela Nr.8 – Analizat bakteriologjike –IKSHP- TM1 2023

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	3	0
	Ujësjiellës	428	0
Suharekë	Burim	0	0
	Ujësjiellës	54	0
Dragash	Burim	0	0
	Ujësjiellës	24	0
Malishevë	Burim	3	0
	Ujësjiellës	72	0
Totali		584	0

Vërejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marra në rrjetin e ujësjiellit është

578 mostra, ku të gjitha mostrat i përgjigjen standarëve të ISHP.

Tabela Nr.9 – Analizat bakteriologjike – KRU- – TM1 2023

Raporti i Analizave Bakteriologjike dhe Fiziko-Kimike, Janar – Mars/2023									
Komuna	Lloji furnizimit	Tipi i mostrës	Totali	Bakteriologjike			Fiziko-Kimike		
				Nr. mostra.	Përgjigj.	Nuk përgjigj.	Nr. mostra.	Përgjigj.	Nuk përgjigj.
Prizren		A	44	22	14	8	22	22	0
	Burim	B	36	18	11	7	18	18	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Burim A+B			80	40	25	15	40	40

		A	136	68	68	0	68	68	0
	Rrjetë	B	56	28	28	0	28	28	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Rrjet A+B		192	96	96	0	96	96	0
Suharekë		A	8	4	2	2	4	4	0
	Burim	B	8	4	2	2	4	4	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Burim A+B		16	8	4	4	8	8	0
		A	24	12	11	1	12	12	0
	Rrjetë	B	22	11	11	0	11	11	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Rrjet A+B		46	23	22	1	23	23	0
Malishevë		A	8	4	3	1	4	4	0
	Burim	B	8	4	2	2	4	4	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Burim A+B		16	8	5	3	8	8	0
		A	20	10	10	0	10	10	0
	Rrjetë	B	18	9	9	0	9	9	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Rrjet A+B		38	19	19	0	19	19	0
Dragash		A	8	4	2	2	4	4	0
	Burim	B	8	4	2	2	4	4	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Burim A+B		16	8	4	4	8	8	0
		A	18	9	9	0	9	9	0
	Rrjetë	B	16	8	8	0	8	8	0
		C	0	0	0	0	0	0	0
	Totali Rrjet A+B		34	17	17	0	17	17	0
KRU "HRJ"	Totali Burim		128	64	38	26	64	64	0
	Totali Rrjet		310	155	154	1	155	155	0

3.4 PROBLEMET E EVIDENTUARA

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas hershme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

3.5 MASAT E REALIZUARA

- Te gjitha defektet ne sistem te ujësjellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohe,
- Është përcjell në mënyrë permanente cilësia e ujit të pijes në nivel regjional,

3.6 MASAT E PROPOZUARA

- Monitorimi i furnizimit me ujë të pijes në gjithë zonën e shërbimit,
- Monitorimi i cilësisë së ujit të pijes në nivel regjional,
- Vazhdimi i analizës se rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe bartja e të dhënave në GIS,
- Implementimi i strategjisë për uljen e UPF-së.
- Aktivitet e shërbimit teknik të ndërmarra për eliminimin e humbjeve teknike.
- Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për detektim.


IV. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

4.1 PERFORMANCAT – TM1-2023

4.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

Tabela Nr.10 – Numri i konsumatorëve – TM1 2023


NUMRI I KONSUMATORËVE			
No.	Të dhënat	TM4- 2024	TM1- 2023
1	Shtëpiak	49,855	50,353
2	Ndryshimi		498
3	Ndryshi. %		
4	Kome.-Indu.	6,324	6,369
5	Ndryshimi		45
6	Ndryshi. %		
7	Institucional	346	346
8	Ndryshimi		-
9	Ndryshi. %		
10	TOTAL	56,525	57,068
11	Ndryshimi		543
12	Ndryshi. %		0.96%



4.1.2 FATURIMI – m3

Tabela Nr.11 – Faturimi m3 – TM1 2023


FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	TM4- 2024	TM1- 2023
1	Shtëpiak	1,512,606	1,487,459
2	Ndryshimi		(25,147)
3	Ndry. %		(1.7)
4	Kome.-Indu.	166,087	149,221
5	Ndryshimi		(16,866)
6	Ndry. %		(10.2)
7	Institucional	119,734	119,996
8	Ndryshimi		262
9	Ndry. %		0.2
10	TOTAL	1,798,427	1,756,676
11	Ndryshimi		(41,751)
12	Ndry. %		-2.3%



4.1.3 FATURIMI – €

Tabela Nr.12 – Faturimi €– TM1 2023


FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	TM4- 2022	TM1- 2023
1	Faturimi-€	1,234,894.21	1,210,353.03
2	Total- Shtëpiak	932,154.64	921,657.44
3	Ndryshimi		(10,497.20)
4	Ndry. %		-1.1%
5	Total- komercial	193,143.11	179,444.91
6	Ndryshimi		(13,698.20)
7	Ndry. %		-7.1%
8	Total-Institucionet	109,596.46	109,250.68
9	Ndryshimi		(345.78)
10	Ndry. %		-0.3%
11	Të tjera	19,296.89	20,852.74
12	Total	1,254,191.10	1,231,205.77
13	Ndryshimi		(22,985.33)
14	Ndry. %		-1.8%



4.1.4 ARKËTIMI – €

Tabela Nr.13 – Arkëtimi €– TM1 2023

No.	Të dhënat	TM4- 2022	TM1- 2023
1	Total- Shtëpiak	972,798.49	947,601.64
2	Ndryshimi		(25,196.85)
3	Ndry. %		-2.6%
4	Total-Komercial-Industrial	203,149.14	152,857.59
5	Ndryshimi		(50,291.55)
6	Ndry. %		-24.8%
7	Total Institucional	130,206.34	78,329.95
8	Ndryshimi		(51,876.39)
9	Ndry. %		-39.8%
10	Total - ujë	1,306,153.97	1,178,789.18
11	Ndryshimi		(127,364.79)
12	Ndry. %		-9.8%
13	Te tjera	16,228.72	18,753.02
14	Ndryshimi		2,524.30
15	Ndry. %		15.6%
16	TOTAL	1,322,382.69	1,197,542.20
17	Ndryshimi		(124,840.49)
18	Ndry. %		-9.44%



4.2 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL

4.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi një faturim më të ulët në krahasim me TM paraprak, si rezultat i rënies së konsumit sezonal.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellësit brenda afatit ligjor të secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar arkëtimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellësit.

4.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Janë shqyrtuar ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Tabela Nr.14 – Ankesat teknike dhe komerciale – TM4 2022

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	703
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	703
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	203
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	203
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	203

Tabela Nr.15 – Ankesat teknike dhe komerciale – TM1 2023

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	635
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	635
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	197
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	197
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	197

4.2.3 INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA

Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.16 – Raport i inspektimit – TM4 2022

Njësitë operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për përmbarrim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorëzuar për gjykatë	Vizita nga ankesat/kërkesat konsumatorëve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	5,202	413	6	15	3,730	19	1	194	116,474
Suharekë	1,177	39	3	3	960	26	0	54	19,765
Malishevë	120	31	0	15	126	26	0	9	0
Dragash	0	6	2	2	22	0	0	2	170
TOTAL	6,499	489	11	35	4,838	71	1	259	136,408.76

Tabela Nr.17 – Raport i inspektimit – TM1 2023

Njësitë operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për përmbarrim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorëzuar për gjykatë	Vizita nga ankesat/kërkesat konsumatorëve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	4,282	391	14	20	2,181	13	1	122	105,034.43
Suharekë	398	34	0	0	2,483	0	0	49	27,776
Malishevë	64	28	13	10	567	71	0	6	8,380
Dragash	0	0	0	0	21	0	0	0	0
TOTAL	4,744	453	27	30	5,252	84	1	177	141,190.81

4.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Mos kontimi i disa ujëmatësve si rezultat i amortizimit të tyre apo arsyeve teknike tjera
- Mos pagesa e obligimeve nga institucionet dhe një pjesë të borxheve të kontraktuara nga një pjesë e madhe e konsumatorëve të cilët kanë nënshkruar kontratë për pagesën e borxheve me këste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare .
- Mos zgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpuara që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, bizneset që kanë falimentuar.

4.2.5 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyçje dhe legalizimeve.
- Aktivitete me përmbarues privat (dalja në teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj.), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasantëve në qytet.
- Janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kësteve nga kontratat për pagesën e borxhit me këste, mirëpo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

4.2.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NË VAZHDIM

- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbaruesi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kësteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi e inspektimit te konsumatorët të cilët nuk kanë qasje për lexim, kapakët e rëndë të pusetave.
- Regjistrimi sa më i shpejt konsumatorëve që të kyçen në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

V. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

5.1 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE

5.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë komfor rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

Përgatitja e raporteve tremujore

Përgatitja e raportit vjetor për vitin 2022;

Pas përmbylljes së shënimeve për vitin 2022, në tre mujorin e parë të vitit 2023, janë bërë regjistrimet e duhura për përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare 2022

Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,

Përgatitja e raporteve mujore financiare, si arkëtimi, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;

Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve;

Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me arkëtimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj.;

Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;

Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;

Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;

Plotësimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarde të kërkuar nga ATK, për muajt përkatës, mujor e tremujor;

Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj., sipas ligjeve në fuqi;

Raportimet tremujore ndaj ARRU-së


Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;

Raportimet tremujore ndaj Agjencisë së Statistikave të Kosovës;

5.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Tabela Nr.18 – Shpenzimet – TM1 2023

SHPENZIMET - €			
No.	Të dhënat	TM4-2022	TM1-2023
1	Total Shpenzimet Operative	1,129,252.00	1,074,838.91
2	Pagat	670,945.00	670,794.20
3	Rryma elektrike	231,739.00	230,041.82
4	Shpenzimet e derivateve	40,320.00	33,017.46
5	Mirëmbajtja dhe riparimet	61,321.00	34,471.14
6	Mirëmbajtja e automjeteve	26,163.00	11,546.13
7	Shpenzimet e taksave	20,179.00	32,865.12
8	Kemikaliet	13,138.00	10,247.83
9	Shpenzimet e tjera	65,447.00	51,855.21
10	Ndryshimi		(54,413.09)
11	Ndryshimi ne %		-4.82%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin TM1- 2023, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të TM4- 2022, janë më të ulëta për -4.8%;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

- Në pozicionin e pagave, shpenzimet e tyre në krahasim me tremujorin e kaluar janë pothuajse të njëjta, por vlen të theksohet se në muajin dhjetor 2022, për të gjithë punëtorët është dhënë shpërblim prej 100 euro për festat e fund vitit dhe në mars 2023, me vendim të Bordit të Drejtorëve, ka hyrë në fuqi vendimi për nivelizimin e pagave të punëtorëve, pra kjo ka bërë një bilanc që shpenzimet e pagave të jenë pothuajse të njëjta;
- Edhe tek pozicioni i energjisë elektrike nuk kemi ndonjë lëvizje të madhe të shpenzimeve, me një rënie të lehtë, pra këto shpenzime varen edhe nga angazhimi i pompave që janë në funksion për nxjerrje të ujit sipas nevojës dhe konsumit;
- Edhe te pozicioni i derivateve kemi një rënie të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor dhe çmimi i derivate ka qenë më i ulët dhe të angazhimit më të paktë të makinerisë në kryerjen e aktiviteteve, për shkak të sezonit dimëror;
- Rënie kemi edhe te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, për shkak se në sezonin dimëror edhe aktivitetet janë më të reduktuara edhe konsumi është me i ulët, por në këtë tremujor ka pasur më pakë nevojë për intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;
- Rënie më të madhe kemi pasur edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti rënie kemi në Njësinë e Prizrenit, pasi që në këtë tremujor, ka pasur më pak nevojë për riparime të makinerisë;
- Ndërsa rritje kemi te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi më shumë lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa kemi rritje edhe të anëtarësisë mujore në SHUKOS edhe asaj të ARRU-së për vitin 2023;
- Te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administratës, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë, shpenzimet e provizioneve etj., edhe këtu kemi ndonjë rënie të kësaj kategorie;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të ulëta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyt e cekura më lartë.

5.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Edhe në këtë Tre mujorë Kompania është ballafaquar me sfida në aspektin financiar :

Obligimet ndaj KEK , për të cilin borxh ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetor është 120,768.00 euro

Pamundësia e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara, ekziston edhe në këtë periudhë. Këto llogari të arkëtueshme, vazhdojnë të procedohen tek përmbaruesi, të cilat përveç që ka vonesa relativisht të mëdha, gjithashtu rrezikohen edhe të parashkruhen nëse ato lëndë prapësohen në gjykatë.

Detyrimet kontigjente - kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë që kanë vendim gjykate shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë ende si i tillë edhe në këtë periudhë tremujore .

5.1.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

Kompania i ka ndërmarrë të gjitha masat që edhe në këtë periudhë t'i siguroj mjetet me kohë për borxhin ndaj KEK-ut në shumë 10,064.00 euro. Pasi që kemi marrëveshje të nënshkruar me përbaruesin për këtë borxh. Ne deri tani kemi arritur të përmbushim me sukses këtë marrëveshje .

Ndërsa për llogaritë e arkëtueshme të vjetërsuara, përveç dërgimit të lëndëve tek përbaruesit privat, ato mundohen t'i kryejnë edhe ekipet e inspektorëve nga shërbimi me konsumatorë.

5.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHË NË VAZHDIM

- Të bëhen përpjekje për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, me ekipet e inspektorëve/kotrollorëve, para se ato të mund të parashkruhen.
- Të bëhet “presion” ndaj përbaruesve privat me qëllim të procedimit të lëndëve me ritëm më të shpejtuar.

5.2 TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

Tabela Nr.19 – Performancat – TM1 2023

Treguesit e Performancës		TM4-2022	TM1-2023
Ujë i faturuar-si përqindje	%	46.5%	46.0%
Ujë i pa faturuar-si përqindje	%	53.5%	54.0%
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	105.8%	97.4%
Norma e arkëtimit - Amvisëritë	%	104.4%	102.8%
Norma e arkëtimit -Komerical-Industrial	%	105.2%	85.2%
Norma e arkëtimit -Institucional	%	118.8%	71.7%
Norma e Mbulimit operativ	numër	1.17	1.12
Staf për 1000 konsumatorë	numër	5.74	5.64

VI. PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

6.1 NJËSIA OPERATIVE- PRIZREN

Tabela Nr.20 NJËSIA - PRIZREN

	TM4-2022	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	2,622,600	2,573,700	(48,900)	-1.9%
<i>Faturimi m3</i>	1,363,515	1,323,252	(40,263)	-3.0%
<i>Faturimi nga uji €</i>	931,337.79 €	907,219.34 €	(24,118)	-2.6%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	12,038.65 €	17,979.75 €	5,941	49.4%
<i>Faturimi Total €</i>	943,376.44 €	925,199.09 €	(18,177)	-1.9%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	1,007,164.47 €	901,392.03 €	(105,772)	-10.5%
<i>Arkëtimi - te tjera €</i>	13,244.72 €	18,982.40 €	5,738	43.3%
<i>Arkëtimi Total €</i>	1,020,409.19 €	920,374.43 €	(100,035)	-9.8%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	38,967	39,350	383	1.0%
<i>% e Arkëtitimit</i>	108.14	99.36	(8.8)	
<i>Shpenzimet</i>	857,302.19 €	818,117.36 €	- 39,184.83 €	-4.6%
<i>Pagat</i>	504,817.11 €	508,751.36 €	3,934.25 €	0.8%
<i>Rryma elektrike</i>	166,646.29 €	166,189.82 €	- 456.47 €	-0.3%
<i>Shpe. e derivateve</i>	30,607.07 €	27,365.00 €	- 3,242.07 €	-10.6%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	46,947.23 €	24,507.38 €	- 22,439.85 €	-47.8%
<i>Miremb. e automjeteve</i>	19,883.36 €	9,183.64 €	- 10,699.72 €	-53.8%
<i>Shpen. E taksave</i>	18,099.54 €	29,095.77 €	10,996.23 €	60.8%
<i>Kemikalet</i>	9,388.90 €	6,593.52 €	- 2,795.38 €	-29.8%
<i>Shpenzimet tjera</i>	60,912.69 €	46,430.87 €	- 14,481.82 €	-23.8%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	1,259,085	1,250,448	(8,637)	-0.7%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	48.01	48.59	0.58	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.19	1.12	(0.07)	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	163,107.00 €	102,257.07 €	- 60,849.93 €	

6.2 NJËSIA OPERATIVE- SUHAREKË

Tabela Nr.21 NJËSIA - SUHAREKË

MUAJI	TM4-2022	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	649,421	632,050	(17,371)	-2.7%
<i>Faturimi m3</i>	268,932	273,328	4,396	1.6%
<i>Faturimi nga uji €</i>	183,989.87 €	186,369.74 €	2,380	1.3%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	5,213.24 €	839.59 €	(4,374)	-83.9%
<i>Faturimi Total €</i>	189,203.11 €	187,209.33 €	(1,994)	-1.1%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	165,578.22 €	162,967.27 €	(2,611)	-1.6%
<i>Arkëtimi - te tjera €</i>	969.00 €	849.59 €	(119)	-12.3%
<i>Arkëtimi Total €</i>	166,547.22 €	163,816.86 €	(2,730)	-1.6%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	9,951	10,072	121	1.2%
<i>% e Arkëtimit</i>	89.99	87.44	(3)	
<i>Shpenzimet</i>	126,665.76 €	117,259.30 €	- 9,406.46 €	-7.4%
<i>Pagat</i>	73,684.02 €	70,007.42 €	- 3,676.60 €	-5.0%
<i>Rryma elektrike</i>	34,137.14 €	31,730.35 €	- 2,406.79 €	-7.1%
<i>Shpe. e derivateve</i>	5,120.61 €	2,939.46 €	- 2,181.15 €	-42.6%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	6,870.07 €	5,011.22 €	- 1,858.85 €	-27.1%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	1,507.27 €	993.88 €	- 513.39 €	-34.1%
<i>Shpen. E taksave</i>	1,067.77 €	2,187.83 €	1,120.06 €	104.9%
<i>Kemikalet</i>	1,580.03 €	1,813.92 €	233.89 €	14.8%
<i>Shpenzimet tjera</i>	2,698.85 €	2,575.22 €	- 123.63 €	-4.6%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	380,489	358,722	(21,767)	-5.7%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	58.59	56.76	(1.83)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.31	1.40	0.08	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	39,881.46 €	46,557.56 €	6,676.10 €	

6.3 NJËSIA OPERATIVE- DRAGASH

Tabela Nr.22 NJËSIA - DRAGASH

MUAJI	TM4-2022	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	234,812	247,800	12,988	5.5%
<i>Faturimi m3</i>	32,312	31,260	(1,052)	-3.3%
<i>Faturimi nga uji €</i>	23,527.86 €	23,346.18 €	(182)	-0.8%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	270.00 €	60.00 €	(210)	-77.8%
<i>Faturimi Total €</i>	23,797.86 €	23,406.18 €	(392)	-1.6%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	29,071.72 €	21,061.46 €	(8,010)	-27.6%
<i>Arkëtimi - te tjera €</i>	297.00 €	60.00 €	(237)	-79.8%
<i>Arkëtimi Total €</i>	29,368.72 €	21,121.46 €	(8,247)	-28.1%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,626	1,628	2	0.1%
<i>% e Arkëtimit</i>	123.56	90.21	(33)	
<i>Shpenzimet</i>	35,652.82 €	33,130.17 €	- 2,522.65 €	-7.1%
<i>Pagat</i>	30,228.57 €	29,731.65 €	- 496.92 €	-1.6%
<i>Rryma elektrike</i>	1,381.28 €	1,699.45 €	318.17 €	23.0%
<i>Shpe. e derivateve</i>	183.35 €	270.35 €	87.00 €	47.5%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	2,296.27 €	562.81 €	- 1,733.46 €	-75.5%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	253.92 €	465.07 €	211.15 €	83.2%
<i>Shpen. E taksave</i>	37.57 €	83.00 €	45.43 €	120.9%
<i>Kemikalet</i>	858.00 €	- €	- 858.00 €	-100.0%
<i>Shpenzimet tjera</i>	413.86 €	317.84 €	- 96.02 €	-23.2%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	202,500	216,540	14,040	6.9%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	86.24	87.38	1.15	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.82	0.64	(0.19)	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	- 6,284.10 €	- 12,008.71 €	(5,725)	

6.4 NJËSIA OPERATIVE- MALISHEVË

Tabela Nr.23 NJËSIA - MALISHEVË

MUAJI	TM4-2022	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	363,633	362,407	(1,226)	-0.3%
<i>Faturimi m3</i>	133,668	128,837	(4,831)	-3.6%
<i>Faturimi nga uji €</i>	96,038.69 €	93,417.77 €	(2,621)	-2.7%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	1,775.00 €	1,973.40 €	198	11.2%
<i>Faturimi Total €</i>	97,813.69 €	95,391.17 €	(2,423)	-2.5%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	104,339.54 €	93,468.40 €	(10,871)	-10.4%
<i>Arkëtimi - te tjera €</i>	1,718.00 €	1,172.40 €	(546)	-31.8%
<i>Arkëtimi Total €</i>	106,057.54 €	94,640.80 €	(11,417)	-10.8%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	5,981	6,018	37	0.6%
<i>% e Arkëtimit</i>	108.64	100.05	(9)	
<i>Shpenzimet</i>	109,630.84 €	106,332.08 €	- 3,298.76 €	-3.0%
<i>Pagat</i>	62,214.80 €	62,303.77 €	88.97 €	0.1%
<i>Rryma elektrike</i>	29,574.23 €	30,422.20 €	847.97 €	2.9%
<i>Shpe. e derivateve</i>	4,409.11 €	2,442.65 €	- 1,966.46 €	-44.6%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	5,207.71 €	4,389.73 €	- 817.98 €	-15.7%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	4,518.79 €	903.54 €	- 3,615.25 €	-80.0%
<i>Shpen. E taksave</i>	974.41 €	1,498.52 €	524.11 €	53.8%
<i>Kemikalet</i>	1,310.59 €	1,840.39 €	529.80 €	40.4%
<i>Shpenzimet tjera</i>	1,421.20 €	2,531.28 €	1,110.08 €	78.1%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	229,965	233,570	3,605	1.6%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	63.24	64.45	1.21	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.97	0.89	(0.08)	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	- 3,573.30 €	- 11,691.28 €	- 8,117.98 €	

6.5 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

Tabela Nr.24 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR”

MUAJI	TM4-2022	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,870,466	3,815,957	(54,509)	-1.4%
<i>Faturimi m3</i>	1,798,427	1,756,677	(41,750)	-2.3%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,234,894.21 €	1,210,353.03 €	(24,541)	-2.0%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	19,296.89 €	20,852.74 €	1,556	8.1%
<i>Faturimi Total €</i>	1,254,191.10 €	1,231,205.77 €	(22,985)	-1.8%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	1,306,153.95 €	1,178,889.16 €	(127,265)	-9.7%
<i>Arkëtimi- të tjera €</i>	16,228.72 €	21,064.39 €	4,836	29.8%
<i>Arkëtimi Total €</i>	1,322,382.67 €	1,199,953.55 €	(122,429)	-9.3%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	56,525	57,068	543	1.0%
<i>% e Arkëtitimit</i>	105.77	97.40	(8.4)	
<i>Shpenzimet</i>	1,129,251.61 €	1,074,838.91 €	- 54,412.70 €	-4.8%
<i>Pagat</i>	670,944.50 €	670,794.20 €	- 150.30 €	0.0%
<i>Rryma elektrike</i>	231,738.94 €	230,041.82 €	- 1,697.12 €	-0.7%
<i>Shpe. e derivateve</i>	40,320.14 €	33,017.46 €	- 7,302.68 €	-18.1%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	61,321.28 €	34,471.14 €	- 26,850.14 €	-43.8%
<i>Miremb. e automjeteve</i>	26,163.34 €	11,546.13 €	- 14,617.21 €	-55.9%
<i>Shpen. E taksave</i>	20,179.29 €	32,865.12 €	12,685.83 €	62.9%
<i>Kemikalet</i>	13,137.52 €	10,247.83 €	- 2,889.69 €	-22.0%
<i>Shpenzimet tjera</i>	65,446.60 €	51,855.21 €	- 13,591.39 €	-20.8%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	2,072,039	2,059,280	(12,759)	-0.6%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	53.53	53.96	0.43	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.17	1.12	(0.05)	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	193,131.06 €	125,114.64 €	- 68,016.42 €	

6.6 REALIZIMI I CAQEVE- TM1-2023

Tabela Nr.25 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR”

MUAJI	CAQET-TM1-2023	TM1-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,998,791	3,815,957	(182,834)	-4.6%
<i>Faturimi m3</i>	1,940,795	1,756,677	(184,118)	-9.5%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,327,948.23 €	1,210,353.03 €	(117,595)	
<i>Faturimi- te tjera €</i>	3,153.52 €	20,852.74 €	17,699	
<i>Faturimi Total €</i>	1,331,101.75 €	1,231,205.77 €	(99,896)	-7.5%
<i>Arkëtimi nga uji €</i>	1,232,556.69 €	1,178,889.16 €	(53,668)	
<i>Arkëtimi- të tjera €</i>	3,153.57 €	21,064.39 €	17,911	
<i>Arkëtimi Total €</i>	1,235,710.26 €	1,199,953.55 €	(35,757)	-2.9%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	56,168	57,068	900	1.6%
<i>% e Arkëtimimit</i>	92.82	97.40	4.6	
<i>Shpenzimet</i>	1,189,943.00 €	1,074,838.91 €	- 115,104.09 €	-9.7%
<i>Pagat</i>	664,112.00 €	670,794.20 €	6,682.20 €	1.0%
<i>Rryma elektrike</i>	263,484.00 €	230,041.82 €	- 33,442.18 €	-12.7%
<i>Shpe. e derivateve</i>	22,382.00 €	33,017.46 €	10,635.46 €	47.5%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	82,653.00 €	34,471.14 €	- 48,181.86 €	-58.3%
<i>Mirem.e automjeteve</i>	19,083.00 €	11,546.13 €	- 7,536.87 €	-39.5%
<i>Shpen. E taksave</i>	25,064.00 €	32,865.12 €	7,801.12 €	31.1%
<i>Kemikalet</i>	34,430.00 €	10,247.83 €	- 24,182.17 €	-70.2%
<i>Shpenzimet tjera</i>	78,735.00 €	51,855.21 €	- 26,879.79 €	-34.1%
<i>Uji I pa faturuar në m3</i>	2,057,996	2,059,280	1,284	0.1%
<i>Uji I pa faturuar ne %</i>	51.47	53.96	2.50	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.04	1.12	0.08	
<i>Mbulimi operativ- €</i>	45,767.26 €	125,114.64 €	79,347.38 €	

6.7 TRANSAKSIONET KRYESORE- TM1-2023

Tabela Nr.26 - 10 pagesat me te mëdha nga Hidroregjioni Jugor për Operoret TM1 2023

Data	Nr. i dokumentit	Nr. I furnitorit	Emri I operatorit	Shuma
13/03/2023	AL-0022425	FUR-01302	Aqualia	502,726.62
24/02/2023	NLB-P-00028266	FUR-01039	KEK - Bunari I	25,261.69
24/03/2023	BPBPZNPOS-005285	FUR-01039	KEK - Bunari I	25,261.69
25/01/2023	BPBPZNPOS-004845	FUR-01039	KEK - Bunari I	25,067.56
10/03/2023	NLB-P-00028341	FUR-01756	CO-ING Afrim S. Ibrahim	23,259.68
23/02/2023	NLB-P-00028259	FUR-01373	Muratori sh.p.k.	13,004.06
06/01/2023	TEB-SH-000002239	FUR-01039	KEK - Bunari I	10,063.84
23/02/2023	PCB-P-00183686	FUR-01815	V SHEHU sh.p.k.	9,672.50
15/02/2023	NLB-P-00028173	FUR-01507	Petrol Company	9,358.70
20/01/2023	TEB-SH-000002281	FUR-01818	Enel Dat sh.p.k.	8,969.98
TOTAL				652,646.32

Tabela Nr.27 - 10 pagesat me te mëdha ndaj Hidroregjioni Jugor për TM1 2023

Data	Kons	Emri I konsumatorit	Banka	Kategoria	Shuma
29.03.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	16,106.85
29.03.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	12,410.30
28.02.2023	KONS-0017603	Filipoviq Jovan	Banka Ekonomike	SHTEPI..Q	6,124.86
29.03.2023	KONS-0029794	SPITALI I QARKUT HEMODIALIZA	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	3,980.79
28.02.2023	KONS-0017598	Hysen Fetahu	Banka Ekonomike	SHTEPI..Q	3,851.33
04.01.2023	KONS-0059600	Galeria Shopping Mall SH P K	Teb Banka	LOKALET	2,554.28
28.02.2023	KONS-0017594	Filipoviq Ljubomir	Banka Ekonomike	SHTEPI..Q	2,175.85
28.02.2023	KONS-0017591	Geoterm Berisha Sh.P.K	Banka Ekonomike	LOKALET	1,955.09
22.03.2023	KONS-0029809	Sh.K.K Qendra e paraburgimit - Prizren	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	1,921.67
14.01.2023	KONS-0003354	NPN DRENARI sh.p.k	NLB Banka	LOKALET	1,855.98
TOTAL					52,937.00

VII. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

7.1 KOMENTET KRYESORE

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore për janar - mars 2023.

Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet e takimeve të Bordit dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve i Kompanisë .

Bordi i Drejtorëve bazuar në Vendimin Nr. KNMU/V/02/2022 të datës 16.02.2022, si dhe në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU” Hidroregjioni Jugor”, pas shqyrtimit të bërë njëzëri ka miratuar “Rregulloren për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës në KRU “Hidroregjioni Jugor”Sh. A.,- Prizren..

Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me rekomandimet e Bordit dhe raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.

Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Malishevës, Dragashit dhe Suharekës si dhe është punuar intenzivisht në procedimin e lëndëve të përmbauesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.

Zyra ligjore është angazhuar edhe në takime zyrtare me Përmbauesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës.

Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.

Në departament të administratës janë përgatitur të gjitha vendimet, që kanë dalë dhe janë aprovuar nga menaxhmenti i Kompanisë

Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lëmin e veprimtarisë së Kompanisë.

Gjithashtu në shërbim të administratës janë lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, përgjigjet në kërkesë, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.

Vlerësimet e performancës për kryerjen e detyrave të punës për punonjësit e KRU

gjatë vitit 2022 janë regjistruar në program gjatë këtyre tre muajve nga Zyrtarja për burime njerëzore.

Janë bere vazhdimet e kontratave te punëtorëve te Kompanisë te cilët kane qene ne afat për gjashte muaj dhe një vite, si dhe te punëtorëve qe kanë pasur kontratën me mundësi te vazhdimet, pas vlerësimit të kryerjes se detyrave te punës të bere nga ana e udhëheqësve te sektorëve .

Për APK është plotësuar raporti i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik për vitin 2022 në KRU" Hidroregjioni jugor" Sh. A, Prizren

Në ARRU është raportuar numri i punëtorëve i ndarë sipas nacionaliteteve, gjinisë, departamenteve, njësive punuese si dhe mosha mesatare e punëtorëve ne Kompani.

Janë plotësuar te dhënat shtesë për punonjësit për vitin 2022 te kërkuara nga ARRU gjatë inspektimit te tyre.

Në seancën e mbajtur me datë 13.01.2023, Komisioni Disiplinor, pas administrimit të provave të parashtruara ka nxjerrë Konstatim se punonjësi M.Sh, i sistemuar në punë dhe detyra të punës Rojtar në K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Njësia Punuese në Malishevë, ka bërë shkelje të detyrave të punës të parapara në Nenin 4 Pika 1, të Rregullores Nr. 01-48/1, datë 19.06.2014 mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U." Hidroregjioni Jugor" Sh.A. me seli në Prizren. Te njëjtit në bazë të Nenit 86, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, i është shqiptuar VËREJTJE ME SHKRIM.

Punonjësit M.P, i sistemuar në punë dhe detyra të punës Rojtar– Kujdestar në Stacionin e Pompave në Novakë, tani i sistemuar për kohësisht Roje tek Shërbimi Fizik i Objekteve në K.R.U." Hidroregjioni Jugor" Sh. A. në Prizren, për shkak të shkeljeve të lehta të detyrave të punës dhe shkeljeve të rënda të detyrave të punës të parapara në Rregulloren Nr. 01-48/1, datë 19.06.2014 mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U" Hidroregjioni Jugor', në bazë të Nenit 86, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i është shqiptuar VËREJTJE ME SHKRIM.

Sipas kërkesë se Menaxherit Teknik janë shpallur konkurs për dy pozita te punës : gjeodet dhe Vozitës I mjeteve te punës MLT. Kërkesa është aprovuar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar dhe i thesarit.

7.1 PERSONELI

Tabela Nr.28

Konkurset TM1-2023

Nr	Pozita e punës	Nr. i kryesve	Dita e shpalljes se konkursit	Njësia
1	Gjeodet	1	22.02.2023	PZ
2	Vozitës I mjeteve te punës MLT	1	22.02.2023	PZ

Tabela Nr.29

Personeli – TM1- 2023

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Janar	321			2	
Shkurt	320				
Mars	321		1	1	

Gjate tre mujorit te pare 2023 ne Kompania Rajonale e Ujësjiellit” Hidroregjioni Jugor “Sh. A në Prizren janë pensionuar 3 (tre) punëtor;

Sh. Basha - Përgjegjës i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit me date 03.01.2023.

K. Krasniqi – Furnizues me date 13.01.2023, dhe

I. Bajraktari - Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit me date 25.03.2023

Tabela Nr.30

Numri i punëtorëve sipas departamenteve dhe mosha mesatare e punonjësve ne HRJ

Administrata	Financa	D. Teknik	D. për konsumatorë	ITUN	NJ. Suharekë	NJ. Malishevë	Nj. Dragash	Mosha mesatare- HJ
45	14	83	79	16	34	34	16	47




Tabela Nr.31

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: MARS 2023

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, A shkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsej
Numri i Punëtorëve	281	32	3	5	321
Nr i Punëtorëve në %	87.5	10	0.9	1.6	

Tabela Nr.32

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	47	14.64	
MESHKUJ:	274	85.36	
TOTAL	321	100.00	

Tabela Nr.33

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: MARS 2023

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH. A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Doktoratë	Mastar	Fakultet	Bachelor	Sh.e mesme	Shkolla fillore	Pa kualif.	Gjiths ej
Nr. i punëtorëve	2	15	23	39	212	29	1	321
Kualifikimi në %	0.62	4.67	7.17	12.15	66.04	9.03	0.31	100.00

Tabela Nr.34

Nr. I PUNËTORËVE SIPAS SHËRBIMEVE

Njësia	Departamenti	Administrata	Teren	Gjithsej
Prizren	Administrata	23	22	45
	Financa	14		14
	Sh. Teknik	23	60	83
	Sh. Konsumator	31	48	79
	ITUN	6	10	16
Njësia	Suhareka	11	23	34
	Malisheva	10	24	34
	Dragash	4	12	16
Totali		122	199	321

Tabela Nr.35

NUMRI I PUNËTORËVE TM1 – 2023

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	ITUN	Total			
1	Janar	327	221	6	16	243	34	16	34
2	Shkurt	326	220	6	16	242	34	16	34
3	Mars	327	220	6	16	243	34	16	34

7.2 ZYRA LIGJORE

Tabela Nr.36 - PËRFAQËSIMI NË GJKATA JANAR – MARS 2023

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Vërejtje
Janar	1	1	2	1	5
Shkurt	3	/	1	/	4
Mars	5	1	2	2	10
Totali	9	2	5	3	19

Tabela Nr.37 - ARDHJET NGA GJKATA DHE INSTITUCIONET TJERA - JANAR – MARS 2023

	Janar	Shkurt	Mars	Total
Aktvendime me aprovime të pjesshme	8	4	4	16
Refuzimet	4	3	/	7
Me përfaqësues	3	2	4	9
Aktvendime pro kompanisë	/	/	4	4
Aktvendime kundër kompanisë	/	3	/	3
Aktgjykime të Kallëzimeve Penale në favor të kompanisë	1	/	2	3
Aktgjykime me të cilat hedhen kallëzimet penale	/	/	1	1
Ndërmjetësime	/	/	2	2
Ftesa për seanca gjyqësore	1	/	6	7
Ankesa kundër kompanisë	/	1	/	1
Aktvendime ku lëndët dërgohen në gjykatën komerciale	/	/	9	9

Tabela Nr.38

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vërejtje
1	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
5	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8	C.nr. 745/05	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	05.09.2005		
	C.nr. 68/17 (Nr. i ri)		
	08.10.2015		
9	C.nr.1902/2019	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10	C.nr.251/20	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë
12	CP.Nr. 1024/20 19.01.2021	Propozim për përmbarim	Në Gjykatën Themelore në Prizren

13	C.nr.363/20	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
14	C.nr.1714/19	Padi – kompensim dëmi material dhe jomaterial	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
15	C.nr.504/19	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
16	A.nr.1064/19	Padi për anulim të Vendimit Nr.2707/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ.
17	C.nr.239/18	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

Paditë e ushtruara nga Kompania

1	J.Sh. F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.313/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
2	N.T.P. Krasniqi,	Padi për kompensim dëmi	
3	Y.Sh., F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.312/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
4	Padi ndaj ATK-së, Prishtinë	A.nr.902/2020	Gjykata Themelore në Prishtinë
5	A.nr. 1648/20, 19.11.2020	Padi për Inicimin e Konfliktit Administrativ	Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ

Tabela Nr.39

PROCEDURA PËRMBARIMORE – TM1 2023

	Janar	Shkurt	Mars	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	33	1	76	110
PRAPËSIME	3	/	4	7
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	3	/	4	7

MARRËVESHJE	10	15	21	46
TË PËRFUNDUARA	8	8	5	21
ANKESË NË GJKATËN E APELIT	1	/	1	2
TËRHEQJE	1	/	/	1
ME PËRFAQËSUES	/	/	1	1
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	9	24	/	33
PRAPËSIME	3	/	/	3
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	3	/	/	3
MARRËVESHJE	/	2	5	7
TË PËRFUNDUARA	2	/	/	2
ME PËRFAQËSUES	1	/	4	5
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	24	/	24
PRAPËSIME	/	1	/	1
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	1	/	1
MARRËVESHJE	/	1	6	7
ME PËRFAQËSUES	/	/	1	1
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
TË PËRFUNDUARA	1	/	/	1

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nën paragrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç 'rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbarimi i lëndës përmbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbarimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbarrim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbarrimit bien mbi kompaninë.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM1-2022, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarrim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

MASAT E PROPOZUARA

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i lexuesve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët. Faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtit të i bindin konsumatorët që të paguajnë të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kaloj borxhi në emër të tij.

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

VII. DEPARTAMENTI I UN -ITUN

7.1 KOMENTET KRYESORE

7.1.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

Veprimtaria e Departamentit të UN- në përfshinë:

Grumbullimin e ujerave të ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve të reja në ndërtim e sipër,

Mirëmbajtjen e ujerave të ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve të reja në ndërtim e sipër,

Konsolidimin e sistemeve ekzistuese dhe Planifikimin e sistemeve të reja të kanalizimeve në nivel regjional,

Trajtimin e ujerave të ndotura përmes Impianteve për trajtimin e ujerave të ndotura të cilat janë ndërtuar, janë në ndërtim e sipër dhe do të ndërtohen në të ardhmen.

Konsolidimin e impianteve ekzistuesi dhe planifikimin e impianteve të reja centrale dhe parciale në nivel regjional,

Monitorimin dhe konsolidimin e ujerave industriale në nivel regjional,

Garantimin e parametrave të efluantit sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuçi të cilat përcaktojnë shkallën e ndotjes e cila lejohet të shkarkohet në trupat pritëse.

Aktualisht jemi duke operuar me ITUN për qytetin e Prizrenit dhe jemi në procedurë të menaxhimit edhe me Impiantin e Bukoshit-Suharekë dhe Impiantin e Kukit-Dragash.

STATUSI I PROJEKTEVE

Statusi i projektit Faza -I-

Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe interceptorëve në rrugë, ana e djathtë e rrjedhjes së lumbardhit.

Ky projekt ka përfunduar në vitin 2017, që nga viti 2017 është në funksion kolektori dhe 7 intereceptorët të cilët shërbejnë për rregullimin hidraulik të kolektorit.

Me këtë rast ju njoftojmë se pompa e cila ka qenë në riparim është sanuar dhe është montuar në kamionin shtytës-thithës. Aktualisht kamioni është në gjendje aktive.

Raporti i kompletimit të projektit për fazën e parë, është dorëzuar dhe miratuar nga KfW, kurse si raport i përfundimtar i cili nënkupton përfundimin e kompletuar të fazës së parë, do të dërgohet së bashku me raportin përfundimtar për fazën 1 dhe 2, pasi që raporti përfundimtar për të dy fazat të miratohet nga KfW-ja, faza 1 e projektit mundë të regjistrohet përfundimisht si aset i kompanisë.

Statusi i projektit te ITUN-se Faza-II-

Dizajnimi, Furnizimi dhe Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Prizren

Meqenëse Periudha e Njoftimit të Defekteve (PNJD-DNP) për linjën e llumit ka përfunduar me 06.10.2022, ju njoftojmë se vazhdojmë të jemi në fazën e pranimit-dorëzimit të projektit të impiantit në Prizren, pasi që disa punë të pa përfunduara janë në proces të përfundimit (furnizimi me material për objektin nr.57), prandaj fillimisht po ju raportojmë për statusin e projektit te ITUN-it.

Projekti i ITUN-it për qytetin e Prizrenit është lëshuar në operim në Dhjetor të vitit 2019 dhe atë gjatë fazës së testimeve të cilat kanë qenë pjesë e kontratës dhe si të tilla kanë qenë aktivitete të realizuara nga kontraktori.

Kjo periudhë e testimeve është ndarë në dy linja, në linjën e ujit të ndotur dhe linjën e llumit.

Testet për linjën e ujit kanë filluar në dhjetor 2019 dhe kanë përfunduar me 24.06.2021, dhe është lëshuar certifikata e përkohshme marrjes përsipër nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect.

Përgjatë kësaj periudhe deri me 24.06.2021, të gjitha shpenzimet operuese dhe të mirëmbajtjes kanë qenë obligim i kontraktorit. Pas kësaj date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se (Periudha e njoftimit të defekteve) për linjën e ujit ka filluar me 24.06.2021 dhe ka përfunduar me 24.06.2022, përmes këtij raporti ju njoftoj se DNP (periudha e njoftimit të defekteve) për linjën e ujit të ndotur ka përfunduar me date 24.06.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk ka linde ndonjë nevojë për zgjatje të kësaj periudhe të DNP-se edhe pse kontraktori AQUALIA i ka sanuar defektet e njoftuara përgjatë kësaj periudhe, tani është në procedurë të përfundimit të punëve të mbetura të cilat duhet ti përfundoj sepse pa përfundimin e punimeve nuk mund të marr certifikatën e performances.

Testet e linjës së llumit kanë filluar në Qershor-2021 dhe kanë përfunduar pjesërisht me datë 04.10.2021 me ç' rast dhe është lëshuar certifikata e përkohshme e marrjes përsipër me vërejtjet dhe komentet përkatëse nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect. Testet kanë përfunduar pjesërisht për shkak të mungesës së llumit sepse në këtë periudhë kohore uji i ndotur në hyrje ka qenë në mesataren e ndotjes bazuar në parametrat e dizajnit.

Përgjatë kësaj periudhe deri më 04.10.2021, të gjitha shpenzimet operuese dhe të mirëmbajtjes kanë qenë obligim i kontraktorit, pas kësaj date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht të Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-së për linjën e llumit ka filluar më 04.10.2021 dhe do të duhej të përfundonte më 04.10.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk do të lindë ndonjë nevojë për zgjatje të kësaj periudhe të DNP-së.

Defektet të cilat janë paraqitur gjatë kësaj periudhe janë sanuar brenda periudhës së DNP-së.

Testet e garancisë janë përsëritur më 24 Tetor të vitit 2022 dhe konsulenca e projektit e ka dorëzuar raportin përkatës për sa i përket testeve të garancisë për linjën e llumit.

Pas përfundimit të DNP-së (Periudhës së njoftimit të defekteve) për të dy linjat është lëshuar raporti i kompletimit i cili është miratuar nga KfW.

Konsulenca e projektit sipas kontratës është e detyruar të përgatisë dhe ta dorëzojë raportin e kompletimit për fazën 1 dhe 2, dhe të njëjtin ta dërgojë tek punëdhënësi dhe tek KfW-ja për miratim. Konsulenca e projektit ka dorëzuar raportin e kompletimit për fazën 1 me datë 02.11.2021, me plotësimet dhe komentet përkatëse të kërkuara nga KfW, dhe është miratuar nga KfW.

Më 8 GUSHT 2022, konsulenca e projektit ka dorëzuar raportin e kompletimit të projektit për fazën 2 për rishikim tek ne dhe tek KfW-ja, ky raport e mbulon periudhën prej fillimit të projektit për fazën 2 e deri tek marrja përsipër e ITUN-së, kurse periudha e njoftimit të defekteve për fazën 2 sipas konsulences do të mbulohet në raportin përfundimtar.

Raporti përfundimtar për fazën 1 dhe 2 ende nuk është përpiluar nga konsulenca e projektit, ky raport do të kompletohet pasi që të kryhet furnizimi me materialin e mbetur për objektin nr.57 si dhe kur kontraktorët do të lëshojnë dokument zyrtar me të cilin dëshmojnë se nuk ka asnjë obligim nderkontraktual në mes të palëve. Pasi që ky raport të përpilohet nga konsulenca duhet të miratohet nga HRJ dhe KfW, në momentin e miratimit të këtij raporti do të nënkuptonte se projekti ka përfunduar tërësisht dhe është i gatshëm për dërgim në kontabilitet i cili është i obliguar të respektoj procedurat e regjistrimit si aset në HRJ.

Kontraktori më datë 29.12.2021, lëshon një deklaratë për kompletimin e projektit me të cilën pretendon për pagesë shtesë duke ju referuar klejmit nr.15 dhe klejmit nr.16, nësi Departament menjëherë kemi reaguar ndaj kësaj deklaratë dhe kemi kërkuar sqarim nga konsulenca e projektit e cila menjëherë e ka njoftuar KfW-në dhe kontraktorin ku dhe përmes letrës zyrtare e ka njoftuar kontraktorin se nuk ka të drejtë për një pretendim të tillë.

Ne si departament rezervojmë faktin se kontraktori AQUALIA nuk do ta kërkojë këtë kompensim, prandaj edhe përmes raportit (TM1, TM2, TM3, TM4)/2022 po ashtu edhe përmes këtij raporti TM1/2023, ju njoftojmë se kjo çështje do të duhej të merret seriozisht nga menaxhmenti i kompanisë, ne si departament bashkë me kryeshefin dhe zyrtarin e lartë financiar e kemi diskutuar me konsulencën dhe KfW-ne, mirëpo kjo çështje ende mbetet e hapur deri sa kontraktori AQUALIA zyrtarisht të na njoftoj se kontrata ka përfunduar dhe nuk kemi asnjë obligim të ndërsjellë kontraktual.

Aktualisht jemi në përmbyllje të projektit për fazën 2, ashtu siç është cekur me lart të gjitha punimet të parapara në kontratë do të pasqyrohen dhe vërtetohen në raportin përfundimtar të projektit të cilin do ta përpilojë konsulencia e projektit dhe do të miratohet nga KfW-ja.

Pasi që të lëshohet raporti përfundimtar i projektit, kontraktori e gëzon të drejtën që të kërkojë certifikatën e performances, në momentin e lëshimit të kësaj certifikate do nënkupton se kontrata në mes të palëve ka përfunduar.

Statusi i projektit Masat Shoqëruese

Shërbimet konsulente për ngritjen institucionale dhe atë teknike për HRJ-ne

Për sa i përket projektit të Masave Shoqëruese faza 2 e cila ka konsistuar në asistencën teknike pas le shuarjes në operim të ITUN-se, kjo periudhë ka qenë e planifikuar në kohëzgjatje prej 18 muajsh duke filluar në janar 2020 dhe do të përfundojë në qershor 2022.

Gjatë kësaj periudhe kjo konsulentë ka zhvilluar këto aktivitete të parapara në kontratë:

Mbikëqyrja dhe verifikimi i punëve të përfunduara,

Mbikëqyrje e procesit të trajnimit,

Monitorimi dhe trajnimi i stafit të laboratorit,

Analiza e SCADA-es dhe hartimi i raporteve të sajë,

Digjitalizimi i planit të mirëmbajtjes përmes MMS,

Mbikëqyrja dhe kërkesat për optimizmin e ITUN.

Kontrata me konsulentë të Masave Shoqëruese DORSCH GROUP ka përfunduar me 30.06.2022, mirëpo nuk janë shfrytëzuar shërbimet opsionale të cilat i ka parapare kontrata.

Me datë 16.06.2022 kemi dërguar kërkesë në KfW për vazhdimin e kontratës me konsulentë të Masave Shoqëruese si vijon:

Siç diskutuam me datë 23 Maj 2022, dëshirojmë të kërkojmë miratimin tuaj për vazhdimin e kontratës Konsulentë të Masave Shoqëruese.

Në të kundërtën Kontrata do të përfundojë me 30 Qershor 2022.

Ky vazhdim do të mbulojë çështjet në vazhdim:

Optimizimi i operimit te WWTP, efijencen e energjisë dhe masat për kursimin e kostos.

Përvetësimi i softuerit te nevojshëm për përdorimin e te dhënave nga SCADA te cilat mundësojnë manovrimin me eficient te veglës se implementuar për te dhënat historike në SCADA.

Trajnime të mëtutjeshme për operim me Laborator.

Akoma janë disa mjete te rimbursueshme dhe shërbime opsionale të mbetura në kontratën e Konsulencës (optional services 1 and 3) qe do te shfrytëzohen për mbulimin e këtij adendumi.

Për më tepër, adendumi do të finalizojë tarifën e ndërprerjes në vlerë prej 8850 Euro për të cilën jemi pajtuar ne e - mailin e datës 04.06.2021.

Ju lutem gjeni te bashkangjitur adendumin e përgatitur nga Dorsch ne te cilën te gjitha pikat janë te përfshira për arsye sqarimi.

KfW-ne e ka pranuar-miratuar kërkesën tone për mundësinë e zgjatjes apo shfrytëzimit te shërbimeve opsionale qe parasheh kontrata me DORSCH GROUP.

Konsulenca Masat Shoqëruese do te përgatisin raportin tremujor qe mbulon periudhën Korrik-Shtator, te njëjtin do ta dërgojnë tek KfW dhe HRJ ne fund te muajit Tetor.

Jemi ne proces te shërbimeve nga konsulenca e Masave Shoqëruese dhe ne Muajin Tetor do te jene prezent ne Impiant përfaqësuesit e Dorsch group.

Për sa i përket adendumit nr.2 për Konsulentët Masat Shoqëruese nga DORSCH GROUP i cili përfshin periudhën 01.07.2022 deri me 31.12.2022 ende nuk e kemi pranuar raportin përfundimtar nga Dorsch, mbi bazën e te cilit do te përshkruhen te gjitha aktivitetet qe i përkasin kësaj periudhe dhe si i tille munde te dorëzohet ne kontabilitet për procedimin e regjistrimit si aset i kompanisë.

Njoftim mbi Inspektimin final te projektit te ujerave te ndotura nga auditori i KfW-se

(Sfondi I inspektimit-auditimit janë Faza 1, Faza 2 dhe Masat Shoqëruese)

Ne fund te muajit Janar dhe fillim te muajit Shkurt kemi pasur një vizite nga auditori gjerman z. Stefan Meshke te cilin e ka angazhuar Banka Gjermane për Zhvillim-KfW me qellim te Inspektimit Final te Projektit te Ujerave te Ndotura për qytetin e Prizrenit, auditori ka qëndruar 5 dite, si përfundim Auditori Gjerman ka përpiluar një procesverbal ose minuta te takimit ku përpos përshkrimit te punës gjate këtyre 5 ditëve dhe falënderimit për ndihmën e dhënë nga ana jone, ky proces verbal përmban: hyrjen, konstatimin, te gjeturat dhe pjesën e rekomandimeve. Si hyrje është bërë një përshkrim i projektit dhe janë shqyrtuar te gjitha procedurat qe nga para kualifikimi e deri tek nënshkrimi i kontratave me kon traktorët, po ashtu janë barazuar vlerat financiare për te gjitha kontratat. Tek pjesa e konstatimeve, është konstatuar se ndërtimit i impiantit është realizuar sipas koncepteve të miratuar paraprakisht, kualiteti i punimeve ka qenë në përgjithësi i nivelit të mirë, pajisjet elektorike mekanike që janë instaluar janë ne përputhje te plote me dizajnin përfundimtar dhe është

konstatuar që impianti është në funksion dhe është duke operuar shumë mirë, kurse tek pjesa e të gjeturave kryesisht behet fjale për objektivat ne aspektin e trajtimit te cilat nuk janë arritur për shkak te shkalles se ulet te ndotjes ne hyrje e cila është nen mesataren e parametrave te dizajnit. Me auditorin kemi shkëmbyer shume korespodenca ku kemi arritur të përfundojmë minutat e takimit dhe ta pranojmë këtë proces verbal si final te cilin edhe e kemi nënshkruar. Ky proces verbal është nënshkruar nga Departamenti UN dhe në përgjithësi mund të them se jemi te kënaqur nga ky auditim dhe nga auditori i angazhuar nga banka Gjermane për Zhvillim-KfW.

Minutat e takimit janë prezantuar ne manexhment nga Departamentin e Ujerave te Ndotura.

Sa i përket këtij raporti TM1/2023 për statusin e projektit te Ujerave te Ndotura-se, e kam paraqitur ne pika me kryesore, ndërkaq për me gjerësisht ekzistojnë raportet periodike dhe tremujore te përpiluara nga konsulenca e projektit dhe raportet e kompletimit te projekteve për fazën 1 dhe 2 te cilat munde ti keni ne dispozicion ne çdo kohe.

Statusi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimit ne qytetin e Prizrenit faza V dhe VI

Ky projekt është bere i mundur falë bashkëpunimit ndërqeveritar te Republikës se Kosovës dhe Republikës Federale Gjermane, përmes KfW-se, e cila pandërprerë ka financuar projektet kryesore për qytetaret e Prizrenit. Një nder kushtet e përfitimit te këtij grandi ka qene edhe vendosja e rrjetit te kanalizimit ne gjeorefernce, konkretisht ne sistemin e GIS-it me te gjitha imputet teknike, kjo është realizuar nga Departamenti ynë dhe aktualisht sistemi I rrjetit te kanalizimit ne kompaninë tone munde te themi se është me I konsoliduar ne nivel sektori.

Prandaj jemi mirënjohës dhe falënderojmë taksapaguesit Gjerman për ndihmën e pandërprerë e cila ka ndikuar pozitivisht ne ngritjen socio-ekonomike për qytetaret e Kosovës e ne veçanti për qytetaret e Prizrenit.

Emri i Projektit:	REHABILITIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT PER QYTETIN E PRIZRENIT
Nënshkrimi I kontratës:	07 Nëntor 2022
Data e fillimit:	21 Nëntor 2022
Vlera e Kontratës:	4,297,232.00 Euro
Kompletimi i projektit:	18 muaj ose 547 dite nga data e fillimit
Agjencioni financues:	KfW-Banka Gjermane për Zhvillim
Detyrat e kontratës:	Ndërrimi i rrjetit te kanalizimit duke filluar nga Fi 150mm deri ne Fi 800 mm
Gjatësia e ndërrimit te kanalizimit:	Rreth 7.5 km

Zona e projektit: funksionimit	Qyteti i Prizrenit, zonat problematike ne aspektin e funksionimit
Përfitues:	KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh.a
mbikëqyrja:	Konsulenca e projektit ne bashkëpunim me Dep. e Ujerave të Ndotura
Fillimi i punimeve në teren:	28.03.2023
Koha aktuale e kontratës:	130 dite
Ditët e mbetura:	417 dite
Koha e përfundimit:	21.05.2024

Ne mes te periudhës 21.11.2023 deri me 28.03.2023 janë bere përgatitjet ne aspektin procedural dhe Teknik, janë nxjerr te gjitha pëlqimet dhe lejet e nevojshme për fillimin e punimeve ne teren dhe janë verifikuar teknikisht te gjitha rrugët te cilat I përkasin këtij projekti.

Aktualisht punimet kane filluar ne zonën nr.4 konkretisht ne rrugën PELLAZGËT me një gjatësi prej L=119m, ne si Departament jemi ne mbikëqyrje ne baza ditore.



Foto të punimeve në rrugën Pellazgët:

7.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

Angazhim dhe menaxhim i përditshëm i aktiviteteve që kanë të bëjnë me operim, funksionim dhe optimizim të ITUN-it në Prizren dhe aktivitete të vazhdueshme për konsolidimin të Departamentit të Ujerave të Ndotura dhe trajtimit të Ujërave të Ndotura në veçanti,

Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet virtuale me donatorë të huaj dhe vendor, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumatorë, me konsulentët e projektit dhe me kontraktorët etj.

Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i aktiviteteve për ITUN-në aktuale dhe projektet tjera potenciale të cilat mundë të përfitohen

në të ardhmen në këtë sektor. Paraqitja, monitorimi, analiza dhe plasimi i të dhënave teknike, financiare dhe administrative tek donatorët potencial si KfW, Qeveria e Kosovës. Komuna e Prizrenit, etj.

Angazhimi si kryetar i komisionit për projektin Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit Faza V dhe VI, përmes korrespondencave të vazhdueshme me konsulentët e projektit dhe KfW-së si agjencion financues i këtij projekti. Monitorimi, krahasimi dhe aplikimi i testeve të analizave në laboratorin e ITUN-it,

Takime të rregullta mujore me stafin aktual të ITUN-it,

Procedimi i kërkesave logjistike dhe atyre investive për nevojat e ITUN-it.

Takimet virtuale me të gjitha palët e interesit janë përshkruar në tabelën si më poshtë,

Pjesëmarrje në cilësinë e anëtarit të komisionit për nivelizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës,

Vizitë në punishte gjatë realizimit të projekteve në baza ditore-Inspektimi i punimeve dhe koordinimi i aktiviteteve,

Vizitë në KRU "HidroregjioniJugor" Sh.A E Min. A. Rizvanolli me 11.012023, me temën performanca e kompanisë dhe projektet investive të HRJ-se,

Projekti Masat Shoqëruese ; vizitë në Impiant-Drejtoresha e projektit nga kontraktori Dorsch Group znj, Laure Nicolet-Misslbeck me 19 janar 2023,

Takimi mujor i janarit faza V dhe VI për Prizren, pa pjesëmarrjen tone,

Inspektimi Final – Ujerat e Ndotura Prizren-30.01.2023 deri 04.02.2023 deri sa u finalizua MoM- dhe ju dërgua auditorit të KfW-së i nënshkruar.

Takim në MMPH për lejen mjedisore, ku u akordua për dokumentacionin që nevojitet për aplikim të lejes Ujore-në vazhdim,

Vizitë me përfaqësues të SHUKOS dhe WSA, tema ngritja kapaciteteve profesionale,

Dërgimi i të dhënave për sasinë dhe kualitetin e llumit z. Admir Shala nga ngrohtorja e Gjakovës,

Dërgimi i të dhënave sipas pikës 8 dhe 9 me kërkesë të MMPH-se - Visar Shehu, për investimin e mundshme të projekteve tona nga Bashkimi Evropian,

Takim me konsulentët SPR&Hidroring dhe kontraktorin Alb Star, me temën Progresi i punimeve,

TIMAK-Rivendosja e pompës shtytëse-Nardi erdhi në Prizren dhe e instaloi pompën shtytëse. Pompa u testua dhe rezultoi e suksesshme,

Takim me ARRU-në për inspektimin e të dhënave për vitin 2022,

Takim me drejtorin e projektit për fazën 5 dhe 6 z. Frank Ehrlicher, inxhinierin rezident Uwe Deutsch dhe Z Skender Bublaku nga konsulenca e projektit SRP&Hidroing me temën mbarëvajtja dhe progresi i projektit,

Nxjerrja e pëlqimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për projektin “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit” Faza 5 dhe 6, me të cilin i lejohet kontraktorit fillimi i punimeve në teren, si dhe të gjitha pëlqimeve tjera të cilat nevojiten për mbarëvajtjen e projektit.

Takim me përfaqësuesit e konsulences SRP&Hidroing z, Skender Bublaku dhe inxhinierin rezident Uwe Deutsch në lidhje me ndryshimet e diametrave të gypave për projektin e fazës 5 dhe 6,

Miratimi nga konsulenca e projektit Faza 5 dhe 6 për ndryshimin e diametrave të gypave përmes analizës teknike dhe financiare,

Dërgimi i kërkesës për miratim të ndryshimit të diametrave të gypave në projektin e fazës 5 dhe 6 në KfW me instruksione të konsulences së projektit,

Plotësimi i pyetësorit për “Grupin e ekspertëve vendorë për ITUN”,

Plotësimi i propozimeve për projektet mjedisore të KRU’HRJ”, me kërkesë të MMPHI-se të cilat janë në procedure të investimeve nga Bashkimi Evropian,

Tabela Nr.40

Takimet virtuale TM1-Janar-Mars-2023

Data	Nikoqiri	Ora	Platforma	Tema	Pjesëmarrësit
10.01.2023	p2m berlin	11:30	Jitsi	SDSW Kosovo, Ph2	Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Lumni Sallahu Kadri Selimaj Annette Ellmers
26.01.2023	p2m berlin	10:00	Jitsi	SDSW Kosovo, Ph2- Diskutim rreth Certifikatës së Performancës dhe Pagesat	Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Lumni Sallahu Kadri Selimaj
01.02.2023	P2m berlin	15:30	Zoom	Diskutim rreth faturave dhe pagesave të konsulencës	Stefan Meshke Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Kadri Selimaj

14.02.2023	P2m berlin	10:00	Zoom	Shqyrtimi I buxhetit	Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Zenel Zenelaj Lumni Sallahu
28.02.2023	P2m berlin	14:00	Jitsi	Diskutimi për letrën e dërguar nga Hidrotermi (second half of retention money)	Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Zenel Zenelaj Lumni Sallahu Kadri Selimaj
10.03.2023	P2m berlin	11:30	Jitsi	SDSW Kosov0, Ph2 - Takimi Hidroterm	Dirk Fitzke Lulzim Pacarizi Zenel Zenelaj Lumni Sallahu

OPERIMI I ITUN-SË PËR PERIU DHËN TM1/2023

Tabela Nr.41

Trajtimi i ujit te ndotur m3 - Janar-Mars, 2023

Muaji	Uji ne hyrje m3/muaj	Uji ricirkuluar- m3/muaj	Uji i trajtuar (m3/muaj)
Janar	285,957	100,329	295,593
Shkurt	267,211	94,392	236,903
Mars	298,580	96,038	162,218
Total	851,748	290,759	694,714

Tabela Nr.42

Stabilizimi i llumit m3 - Janar-Mars, 2023

Muaji	Llumi pompuar nga sedimentuesi primar m3/muaj	Llumi pompuar nga sedimentuesi sekondar- m3/muaj	Llumi i deponuar ne shtretër (m3/muaj)
Janar	1390	573	491
Shkurt	825	546	6
Mars	978	567	7
Total	3193	1686	504

Tabela Nr.43**Mirëmbajtja e planifikuar sipas aplikacionit MMS – Janar-Mars, 2023**

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Janar	320	153	208
Shkurt	487	238	191
Mars	496	238	222
Total	1303	629	621

Tabela Nr.44**Mirëmbajtja emergjente sipas aplikacionit MMS – Janar-Mars, 2023**

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Janar	/	/	/
Shkurt	/	1	3
Mars	/	1	/
Total	0	2	3

**Raporti mbi cilësinë e ujit ne hyrje dhe ne dalje te ITUN-se për TM1 Janar-Mars, 2023 nga
Lab. i kompanisë**

Duhet theksuar se laboratorit i ITUN-it është ndër objektet më të rëndësishme të impiantit, i cili mundëson që të arrijmë optimizim sa më të mirë të ITUN-it, pasi qe optimizimi i ITUN-it është në funksion të rezultateve që gjeneron laboratorit pas analizimit të mostrave si në hyrje, si pas dekantimit primar po ashtu edhe ne dalje te ITUN-it. Funksionimi i mirë i laboratorit do të na mundësojë plotësimin e kriterëve ambientale për sa i përket parametrave shkarkues të cilat lejohen të shkarkohen në trupat pritës siç është, në rastin tonë, lumi Lumbardh.

Kapacitetet e laboratorit na mundësojnë ekzaminimin e mostrave të ujit të ndotur sipas kërkesave ligjore ambientale dhe kemi kapacitet të tillë ku mundë të planifikojmë ekzaminimin e të gjitha mostrave në nivel regional dhe me gjerë.

Jemi dhe do te vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe të bashkërendojmë aktivitetet edhe me laboratorët në nivel të sektorit.

Tabela Nr.45

Analizat, Janar-Mars, 2023 – Sipas UD 15-2008, MMPH

ITUN-Prizren

ITUN-Lokacioni	Lloji i ujit	Nr., i mostrave	I përgjigjet	Nuk i përgjigjet
Prizren	Hyrje	10+12+13	35	0
Prizren	Pas dekenatimit primar	0	0	0
Prizren	Ne dalje	10+12+13	35	0
Totali		70	70	0

- ITUN-Bukosh, Suhareke, ende nuk është nen menaxhim te HRJ-se
- ITUN-KUK-Dragash, ende nuk është nen menaxhim te HRJ-se

7.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Problemet me furnizim të energjisë elektrike nga ana e KEDS kanë një rënie të dukshme pasi qe furnizimi gjatë këtij tremujori ka qenë më stabil.

Mungese e stafit-(3 Roje, 1 punëtor fizik, 1 Punëtor mekanik, 1 Teknik të elektros dhe 1 mirëmbajtës), kërkesa është dorëzuar në muajin Korrik-2022.

7.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

E gjithë mirëmbajtja e planifikuar sipas MMS-it është realizuar në afat të paraparë.

Të gjitha sanimet e defekteve emergjente janë sanuar me kohë.

Janë zbatuar manualet si në operim si në mirëmbajtje po ashtu edhe në mbrojtje dhe siguri në punë.

Jemi duke e konsoliduar Departamentin e Ujërave të Ndotura në të cilin do të përfshihet edhe mirëmbajtja e sistemit te kanalizimit në nivel regjional dhe Autoparku bashke me Oficinën punuese.

7.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

Monitorimi i sistemit të kanalizimit dhe pusetave kapërderdhës (Interceptoreve),

Monitorimi i fazave të trajtimit për një cikël sa më efikas,

Monitorimi i cilësisë së ujit në hyrje, pas dekantimit primar dhe në dalje,

Vazhdimi i aktiviteteve në mirëmbajtjen e planifikuar sipas SOP Procedurave Standarde të Operimit.

Instalimi i kamerave për sigurimin e zonës së parë mbrojtëse.

Efikasiteti në aspektin logjistik, furnizimi me kohë me kemikate për laborator.

Efikasiteti në aspektin logjistik, furnizimi me kohë me naftë dhe material fazonerik të nevojshëm për intervenime emergjente.

Vazhdimësia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë për stafin e ITUN-se dhe ndaj stabilimenteve punuese të ITUN-it.

Kompletimi i stafit të nevojshëm për efikasitetin e punës në ITUN.

Mirëmbajtje me efikase e hapësirës së ITUN-se pasi që është sipërfaqe shume e madhe dhe nevojitet angazhim si ne fuqi punëtore po ashtu edhe makinerie.

Takimet me kryetarët e Komunave përkatëse në lidhje me:

Konsolidimin e sistemeve ekzistuese të kanalizimit dhe planifikimit të sistemeve të reja të kanalizimit.

Mundësia e marrjes në menaxhim të Impiantit në fshatin Kuk, komuna Dragashit dhe në fshatin Bukosh, komuna e Suharekës.

Mundësia e përpilimit të Master Planeve për zgjerimin e shërbimeve përmes sistemeve të reja të kanalizimit po ashtu edhe Impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura për secilën Komunë, ku ofrojmë shërbime përkatëse.

Në muajin Shkurt kemi takim pune me përfaqësues të komunës së Suharekës, ku kemi diskutuar mbi studimin aktual të fizibilitetit për projektin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura dhe kolektimit të ujërave të ndotura për qytetin e Suharekës dhe disa fshatra të komunës së Suharekës (dy zona dhe tri opsione).

Në muajt në vazhdim do të fillojmë aktivitetin mbi hartimin e Planit të veprimit për sa i përket konsolidimit të Departamentet të Ujërave të Ndotura si dhe aktiviteteve të cilat do të përshkruhen në këtë plan Veprimi.

VIII. AUDITIMI I BRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet përmbledhjen dhe prezantimin e punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të katërt të këtij viti (TM4/2022), gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore tetor – dhjetor 2022.

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezantimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të parë të këtij viti, gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore janar – mars 2023.

- Gjatë kësaj periudhe, është përgatitur raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin paraprak 2022. Raporti në formë në mënyrë kronologjike, prezanton punën njëvjeçare të auditorit të brendshëm, lidhur me:

- auditimet e realizuara,

- subjektet - departamentet, njësitë, shërbimet etj, ku janë realizuar auditimet;

- prezantimi i të gjitha konstatimeve, të gjeturave, rekomandimeve dhe komenteve;

- rishikimin e rekomandimeve të dhëna si dhe nivelin e adresimit të rekomandimeve; si dhe

- performanca e realizimit të caqeve të punës së auditorit, të përcaktuara me plan vjetor 2022.

- Bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2022, të aprovuar nga Komisioni i Auditimit, sipas planifikimit është vepruar në auditimin e proceseve, sikurse:

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave – faturimit të kompanisë,

- Auditimi lidhur me realizimin dhe implementimin e Projektit për Komunën e Mamushës,

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të shpenzimeve (në proces).

- Në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm janë mbajtur takimet me subjektet e audituara, dhe janë përgatitur raportet e auditimit.

- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimit, edhe përkundër disa të gjeturave dhe dhënies së rekomandimeve, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave, është kryer:

- në pajtim me dispozitat ligjore,

- është treguar një performancë e mirë në shërbimin e kontabilitetit, si dhe

- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

- Gjithashtu, në pajtim me kërkesat ligjore, është përgatitur Raporti Vjetor për NJQH të AB të Ministrisë së Financave, lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm për vitin 2022.

- Gjatë kësaj periudhe është bërë rishikimi i adresimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e periudhës tremujore TM4/2022. Në bazë të dëshmive të ofruara nga menaxherët e subjekteve audituese, në formë përmbledhëse janë paraqitur në raportet si në vijim:

Tabela Nr.46

Proceset e audituara – TM1-2023

Nr	Proceset e audituara TM4/2022	Subjektet e audituara	Nr. rekomand.
1.	Menaxhimi i procesit të inkasimit në Shërbimin me Konsumatorë në Nj.P. Prizren	Dep. Regjional me Konsumatorë	3

2.	Menaxhimi i transportit - procesi i përdorimit të automjeteve zyrtare në ITUN/ KRU "HRJ"	Dep. Teknik dhe Dep. ITUN	2
3.	Menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në NjP Suharekë	NjP/Suharekë	2
4.	Menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në NjP Malishevë	NjP/Malishevë	2
5.	Menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në NjP Dragash	NjP/Dragash	1
6.	Menaxhimi i procesi i faturimit të konsumatorëve NPT "Abi & Elif 19" dhe "Galeria Shopping Mall" SHPK	Dep. Regjional me Konsumatorë	2
7.	Menaxhimi i procesit të rekrutimit të punonjësve për pozitat arkëtare dhe punëtorë në bazhdarim, në NjPrizren.	Dep. Adm. dhe Personelit / Z.Ligjore	2

IX. AKTIVITETET E PROKURIMIT – TM1-2023

Tabela Nr.47

Titulli i kontrates	Kodi intern i procedurës	Data e nenshkrimt	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates	Vërejtje
Furnizim me pjese atomjeteve dhe mirmbajtje	70433702-23-17-1-1-1					Ndodhet ne fazen para dhenies se kontrates
Shërbim -Kontrollimi Teknik i automjeteve zyrtare të KRU- Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren, Suharekë,Malishevëdhe Dragash.	70433702-23-46-2-3-6					Anuluar ne mungese te ofertuesve

Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve në zonën e shërbimit për periudhën janar-dhjetor 2022 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" sha	70433702-23-347-2-3-6	24.02.2023	24.03.2023(Brenda 1 Muaj)	D&D Business Support Center L.L.C.	1,150.00 €	
Furnizim me tonera per printera.	70433702-23-355-1-3-6					Ndodhet ne fazen e Rivleresimit
Furnizim me material higjienik për nevojat e kompanisë KRU Hidroregjioni Jugor sh.aPrizren , njesite e saj operuese (Suharekë, Malishevë dhe Dragash) si dhe Impianti për trajtimin e ujrave të zeza(ITUN).	70433702-23-1220-1-2-1					Ndodhet ne fazen para dhenies se kontrates
Servesimi i dy ujëmatesave të prodhimit të ujit ujëmatesat elektromagnetik-DN 300mm dhe DN 350mm.	70433702-23-1617-2-3-6					
Furnizim me material zyrtar administrativ	70433702-23-1895-1-2-1					Hapja e ofertave do te behet 07.04.2023
Sigurimi i automjeteve zyrtare,TPL						
Furnizim me ujëmatës të prodhimit të ujit,ujëmatës ultrasonik-DN 600mm.	70433702-23-2396-1-3-6					Hapja do te behet me 04.04.2023
PROCEDURAT ME VLERE MINIMALE PER VITIN FISKAL 2023						
Sigurimi TPL Per veturat PZ	70433702-23-144-2-4-7	19.01.2023		KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.	987.21€	
Furnizim me Karrige rrotative per zyre	70433702-23-1450-1-4-7	02.03.2023		"TRENDY HOME" SH.P.K.	420.00€	

Drek per rastin e 8 Marsit per grat	70433702-23-1793-2-4-7	07.03.2023	VILA PARK SH.P.K.	880.00€
Furnizim me pjes per veturat, Kamion & makineri	70433702-23-2016-1-4-7	14.03.2023	Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "	960.00€
Furnizim me PC I5	70433702-23-2499-1-4-7	23.03.2023	AVNI HALITI B.I.	900.00€

X. INVESTIMET KAPITALE

INVESTIMET E PËRFUNDUARA, NË PROCES DHE TË PLANIFIKUARA

JANAR- MARS -2023

Tabela Nr.48

INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE		Të përfunduara	Në proces	PB 2023	Realizimi në %
Nr.			2023	2023	2023
1	NJ.P. - PRIZREN	63,139.72	725,900.00	725,900.00	8.70%
2	NJ.P. - SUHAREKË	36,330.46	80,000.00	80,000.00	45.41%
3	NJ.P. - MALISHEVË		40,000.00	40,000.00	0
4	NJ.P. - DRAGASH		19,000.00	19,000.00	0
5	NJ.P. - MAMUSHË		2,000.00	2,000.00	0
	KRU,,HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A	99,470.18	866,900.00	866,900.00	11.47%

Tabela Nr.49

INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET		Të përfunduara	Në proces	PB 2023
Nr				2023
1	NJ.P. - PRIZREN		752,500.00	22,260,000.00
2	NJ.P. - SUHAREKË			6,550,919.79
3	NJ.P. - MALISHEVË		120,000.00	5,709,000.00
4	NJ.P. - DRAGASH		2,300,000.00	1,690,000.00
5	NJ.P. - MAMUSHË			17,500.00
	KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A	0.00	3,172,500.00	36,227,419.79

XI. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ZVOGLIMIN E UPF-së

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZVOGËLIMIN E UJIT TË PAFATURUAR

Raporti për Progresin e Arritur

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

Periudha Raportuese: **Janar - Mars 2023**

1. Emri dhe mbiemri i Koordinatorit/Personit të ngarkuar për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë:	Besar Grazhda
2. Sa ishte shkalla e UPF për vitin 2022 (%):	54.40 %
3. Cili është caku i planifikuar për zvogëlimin e UPF për vitin 2023 (%):	51.95 %
4. Rezultatet e realizuara në 6-mujorin e parë të vitit 2023 (%):	
1) Janar : 53.90 % ; 2) Shkurt : 54.00 % ; 3) Mars : 54.40 % ; mesatarja tre-mujore: 53.96 %	
5. Kapacitetet organizative të Kompanisë të angazhuara për zbatimin e Strategjisë:	
5.1 Numri i ekipeve të kontrollit secilën prej njësive operative:	Në K.R.U"Hydroregjioni-Jugor", operojnë 8-ekipe të kontrollit në nivel regjional. <ul style="list-style-type: none">• Prizren – 4 ekipe• Suharekë – 2 ekipe• Malishevë – 1 ekipe• Dragash – 1 ekip
5.2 Numri i ekipeve të shkyçjes për secilën njësi operative:	Secili ekip i kontrollit, ka autorizim të plotë, të shkyçjes së konsumatorëve
5.3 Sa shpesh mbahen takimet e menaxhmentit për monitorim dhe koordinim të aktiviteteve për zvogëlimin e UPF?	Dy herë në muaj
5.4 Aktivitete tjera (të përshkruhen)	<ul style="list-style-type: none">• Janë evidentuar numri i sakte i sakte i konsumatorëve pa konsum (edhe sipas Njësive punuese)• Janë duke u inspektuar të gjithë këta konsumatorë

<p>6.1 identifikimi dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin); (sa konsumatorë janë shkyçur gjatë periudhës raportuese për shkak të kyçjes ilegale/vjedhjes së ujit? – te mos përfshihen shkyçjet për mos pagesë të faturave)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhjet e paligjshme: 27 • Konsumatorë të legalizuar: 453 • Verifikimi i ujëmatësve: 5,252 • Nr. i leximeve te gabuara: 84 • Vizitat sipas ankesave: 177
<p>6.2 identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin); (sa konsumatorë janë proceduar penalisht për veprime të sanksionuara me Kodin Penal, si: vjedhja e manipulimi me ujëmatës, manipulimi i pllombës etj.).</p>	<p>Raste te dorëzuara ne gjykatë: 2</p>
<p>6.3 identifikimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional (sa ujëmatës janë zëvendësuar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekípet e kompanisë gjatë kësaj periudhe në nivel regjional, gjithsej kanë zëvendësuar (ndërruar) 283 -ujëmatës, te konsumatorët që ujëmatësit kanë qenë jashtë funksionit (defekt).
<p>6.4 instalimi i ujëmatësve te konsumatorët që nuk kanë ujëmatës (sa ujëmatës janë instaluar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekípet e kompanisë gjatë kësaj periudhe në nivel regjional, gjithsej kanë instaluar 543 -ujëmatës, te konsumatorët që nuk kanë pasur ujëmatës.
<p>6.5 riparimi i rrjedhjeve (sa është numri i rrjedhjeve të riparuar?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i rrjedhjeve te riparuar ne nivel regjional 643 -riparime në sistemin e ujësjellësit
<p>6.6 zëvendësim i rrjetit të vjetërsuar (sa është gjatësia e rrjetit të zëvendësuar)</p>	<p>Zëvendësimi i rrjetit te vjetërsuar dhe zgjerimi i zonës se shërbimit, janë instaluar gypa te PE-100 :</p> <ul style="list-style-type: none"> • DN 315=200m’ • DN 250=443m’ • DN 110=230m’ • DN 63=2,390m’
<p>6.7 aktivitete tjera - të përshkruhen (p.sh. formimi i DMA-ve, pllombimi/vulosja e ujëmatësve, menaxhimi i presioneve, kontrolli aktiv i rrjedhjeve etj.).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Detektimi i rrjeti te ujësjellësit ne nivel regjional me gjatësi L=3,910 m’, 157 raste për detektim ku janë gjetur 97 defekte. • Bazhdarime të ujëmatësve ne nivel regjional janë 299 riparime/bazhdarim te ujëmatëseve. • Pllombime te ujëmatëseve gjithsej 484 ujëmatës po ashtu edhe 57 ribllombime te ujëmatëseve. • Monitorim i zonave DMA, në baza mujore • Analizim dhe monitorim i MNF(Minimum Night Flow) nga të dhënat e datallogerëve në DMA

7. Vështirësitë/problemet kryesore gjatë zbatimit të Strategjisë:
(të përshkruhen)

Vështirësitë dhe problemet të cilat më së shumti hasen gjatë zhvillimit të aktiviteteve për zvogëlimin e humbjeve janë :

- Çasje të vështirësuar në leximin e ujëmatësve shtëpiak/komercial
- Besueshmëri e ulët në leximin e ujëmatësve të prodhimit dhe atyre zonal
- Mungesë e investimeve direkte në zvogëlimin e UPF
- Koordinim më specifik, në mes të palëve të interesit, Kompani Rajonale, Komuna, Ministri
- Mungesë e pajisjeve profesionale për detektimin e rrjedhjeve
- Vështirësi në grumbullimin/matjen e të dhënave nga tereni
- Vështirësi në identifikimin e ujëmatësve shtëpiak të pa-kalibruar
- Aktivitete senzibilizuese me konsumatorë

XII. RAPORTIM FINANCIAR PËR MINISTRIN E FINANCAVE

Tabela Nr.50

Nr.	Emërtimi	2023 Tremujori TM1 - Aktuale
1	Te Hyrat totale	1,408,819.64
2	Te Hyrat nga aktiviteti tregtar	1,231,205.77
3	Grandet Qeveritare	
4	Kostoja e Shitjes	
5	Profiti Bruto	1,231,205.77
6	Te hyra te tjera	177,613.87
7	Shpenzimet totale operative	1,504,556.03
8	Shpenzimet e stafit	670,794.20
9	Zhvlerësimi/ Amortizimi	314,380.58
10	Fitimi Operativ (EBIT)	- 95,736.39
11	Shpenzimet e Financimit	
12	Te hyrat e financimit	
13	Fitimi (Humbja) Tjetër Jo-Operativ	
14	Fitimi (Humbja) para Tatimit	- 95,736.39
15	Tatimi	
16	Fitimi (Humbja) pas Tatimit	- 95,736.39
14	Dividendi i deklaruar	
15	Asetet jo- rrjedhëse	32,754,877.62
16	Asetet rrjedhëse	2,411,744.35
17	Inventari	
18	Llogarite e arkëtueshme	989,543.33
19	Parate	1,422,201.02

20	Asetet Totale	35,166,621.97
21	Gjithsej kapitali	13,406,994.97
22	Detyrimet jo-rrjedhëse	20,282,082.52
23	Detyrimet rrjedhëse	1,477,544.48
24	Llogarite e pagueshme	1,432,458.56
25	Detyrimet Tatimore	45,085.92
26	Detyrimet Totale	21,759,627.00
27	Paraja Neto e gjeneruar nga aktivitetet operative	
28	Paraja Neto e gjeneruar nga aktivitetet investive	
29	Paraja Neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese	
30	Grandet/ Subvencionet/ Transferet rrjedhëse te Qeverise	
31	Grandet/ Subvencionet/ Transferet kapitale te Qeverise	
32	Rritja/ Zvogëlimi Neto ne Huate Qeveritare	
33	Injeksionet e Kapitalit te Qeverise	
34	Numri i punëtoreve	327

XIII. ORANOGRAMI

